



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

**RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE
Efektiviteti i programeve për përballimin e
pasojave të fatkeqësisë natyrore 2019ö**





PËRMBAJTJA

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	6
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	7
2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM	7
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim	7
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	9
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	11
2.4 Peshë në buxhet dhe PBB.....	13
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia	13
2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore.....	23
3. DETAJET E AUDITIMIT	23
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	23
3.2 Objektivi i auditimit.....	25
3.3 Pyetjet e auditimit	25
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	26
4. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE.....	33
5. PËRMBLEDHJE.....	63
6. SHTOJCA.....	64
7. GRUPI I PUNËS.....	69

✂ **LISTA E SHKURTIMEVE**

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KSHR	Komisioni Shtetëror i Rindërtimit
KMC	Komiteti i Mbrojtjes Civile
MSHR	Ministri i Shtetit për Rindërtim
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhillimit
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifimit të Territorit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit <i>(The International Organisation of Supreme Audit Institutions)</i>
PDNA	Post-Disaster Needs Assessment (Vlerësimi i nevojave pas katastrofës)
PKEC	Plani Kombëtar për Emergjencat Civile
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit <i>(International Standards of Supreme Audit Institutions)</i>
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
SKZRF	Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit të Bashkisë

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL

Shqipëria u godit nga një tërmet i fortë me magnitudë 6.3 të shkallës Richter në thellësi 38 km. Epiqendra e këtij tërmeti ishte 22 km nga Durrësi dhe 30 km nga Tirana. Në këtë zonë në të cilën bashkohen Pllaka Euroaziatike dhe Pllaka Adriatike kanë ndodhur shumica e tërmeteve të regjistruara në vendin tonë. Si rezultat i këtij tërmeti u prekën në total 202,291 njerëz, nga të cilët, 47,263 në mënyrë direkte dhe 155,029 indirekt. Tërmeti shkaktoi 51 humbje jete nga të cilët shtatë ishin fëmijë të moshës 0-14 vjeç, 34 të moshës 15-59 vjeç dhe 10 të tjerë të moshës mbi 60 vjeç. Gjithashtu, 913 njerëz u plagosën. Në total u arritën të shpëtoheshin 48 njerëz, 38 nga ekipet e shpëtimit dhe 10 të tjerë nga njerëz të rastësishëm që i dhanë ndihmën e pare të prekurëve nga tërmeti.¹Rreth 17,000 njerëz u zhvendosën si rezultat i humbjes së shtëpive të tyre. Autoritetet kryesore të vendit tonë e përshkruan tërmetin e 26 Nëntorit të 2019 si më të fortin e 30 viteve të fundit. Bashkitë më të prekura nga ky tërmet rezultuan Shijaku, Durrësi, Kruja, Tirana, Kamza, Kavaja, Vora, Kavaja, Rogozhina, Kurbini dhe Mirdita.²

Referuar PDNA (Post Disaster Needs Assessments-Vlerësimet të Nevojave Post Katastrofë) i cili është dokumenti i vetëm që ka grumbulluar vlerësimet e efekteve dhe dëmeve³ të shkaktuara nga tërmeti i nëntorit të 2019 shuma totale e shkatërrimit në 11 bashkitë përllorarit afërsisht në 985 milionë euro (121.1 miliardë lekë). Shumica e dëmeve është regjistruar në sektorin e banesave (78.5%), e ndjekur nga sektori i Prodhimit (8.5 %) dhe sektori i arsimit (7.4 %). Referuar pronësisë, 76 % të tyre kanë ndodhur në pronë private dhe 23.5 % në pronë publike. Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të dëmit dhe humbjes (Tabela 2), Bashkia e Durrësit është më e prekura ku dëmet përllorariten në 303.8 milion EURO (3.74 miliardë lekë) ose 32.4% e totalit, e ndjekur nga Bashkia Tiranë me 284.3 milion euro (3.5 miliardë lekë) ose 30% e totalit, e më tej Kruja me 84.2 milion EURO (1.04 miliardë lekë) ose 9% e totalit e me radhë Bashkitë e tjera.⁴

Tabela 1. Dëmet dhe humbjet, sipas sektorëve dhe nënsektorëve

Sektor	Nën Sektor	Dëmet	Humbjet	Total
			në milionë EURO	
Shëndeti		8.02	1.91	9.93
Arsimi		63.59	8.76	72.35
Banesa		662.30	34	696.3
Prodhimtaria		70.82	79.66	150.48
	Biznesi dhe Punësimi	47.48	5.47	52.95
	Turizmi	16.71	73.53	90.24
	Trashëgimi Kulturore	5.31	0.44	5.75
	Agrikultura(Bujqësia)	1.32	0.22	1.54
Infrastruktura		30.41	3.01	33.42

¹Post-Disaster Needs Assessment, Volume A, the Government of Albania, the European Union, the United Nations agencies, and the World Bank 2020, fq 16.

²Post-Disaster Needs Assessment, Volume A, the Government of Albania, the European Union, the United Nations agencies, and the World Bank 2020, fq 6,7.

³ Dëmet janë shkatërrimi i pjesshëm ose i plotë i infrastrukturës fizike, ndërsa humbjet janë vlera e të ardhurave të reduktuara si dhe kosto shtesë me qëllim ofrimin e të njëjtit shërbim apo funksion.

⁴Post-Disaster Needs Assessment, Volume A, the Government of Albania, the European Union, the United Nations agencies, and the World Bank 2020, fq 8.

Infrastruktura e Komunitetit	6.06	0.16	6.22
Rrugët	4.83	0.43	5.26
Uji dhe kanalizimi	0.35	0.00	0.35
Komunikimi	0.92	0.16	1.08
Ndërtesat Publike	10.07	2.26	12.33
Energjia	8.18	0.00	8.18
Mbrojtja Sociale		0.62	0.62
Mbrojtja Civile	8.75	13.22	21.97
Total	843.89	141.17	985.06

Burimi: Post-Disaster Needs Assessment, Volume A, fq. 8

Tabela 2. Dëmet dhe humbjet sipas bashkive (në milionë euro)

Bashkitë	Arsim	Shëndetësi	Banesa	Infrastrukturë	Prodhimtari	Mbrojtje sociale	Mbrojtje civile
Durrës	9.75	1.50	220.78	8.95	65.15	0.06	4.00
Shijak	2.40	0.11	52.91	1.84	5.36	0.06	2.30
Kruja	5.04	0.34	73.01	0.53	5.67	0.06	1.50
Lezha	2.91	0.27	22.18	1.38	6.83	0.06	2.00
Mirdita	-	-	4.42	0.80	0.75	0.06	0.70
Kurbin	4.00	5.56	25.39	2.32	0.05	0.06	2.40
Tirana	46.06	2.13	214.33	15.56	21.91	0.06	3.40
Kamza	0.06	-	14.49	0.49	1.25	0.06	1.82
Vora	1.18	0.02	40.16	1.00	5.59	0.06	1.80
Kavaja	0.93	-	28.62	0.50	37.79	0.06	1.30
Rrogozhina	-	-	-	0.05	0.14	0.02	0.75
Totali	72.35	9.93	696.30	33.42	150.48	0.62	21.97

Burimi: Post-Disaster Needs Assessment, Volume A, fq. 8

Vendndodhja e tërmetit nuk ishte surprizë duke qenë se historikisht ngjarjet sizmike të ndodhura e të regjistruara midis Pllakës Euroaziatike dhe Pllakës së Adriatikut, pjesë e zonës komplekse të përplasjes me Pllakën Afrikane, ku kompresimi tektonik i kores së Tokës që shtrihet nga Kroacia në veri deri në Greqi në jug ka dhënë rritje të lëvizjeve sizmike. Në këtë kontekst, pjesaperëndimore e Shqipërisë është e predispozuar për goditje të tilla.

Investimet në reduktimin e rreziqeve të katastrofave shpëtojnë jetë dhe zbusin dëmet. Përdorimi i burimeve dhe shpenzimet për marrjen e masave paraprake për reduktimin e katastrofave mund të jenë më efektive dhe eficiente se sa ofaturaë për përgjigje dhe rindërtim ndaj katastrofës. Në 2010, Pakistani u godit nga përmytjet më masive në historinë e tij. Shteti i Pakistanit pati rreth 10 miliardë dollarë dëme dhe shpenzoi rreth 3 miliardë dollarë për lehtësimin e tyre. Presidenti i Agjencisë së Menaxhimit të Katastrofave Kombëtare të Pakistanit citoi se: - Ënëse do të kishim harxhuar rreth 40 milionë dollarë në marrjen e masave për mirëmbajtjen e infrastrukturës, humbjet do të ishin vetëm 1/10 ose rreth 1 miliardë dollarë. Ne do të kishim qenë të aftë të shpëtonim shumë prona e jetë njerëzish dhe trauma në popullsi do të ishte shumë herë më e vogël. Shumë studime kanë treguar se reduktimi i rreziqeve të katastrofave është shumë herë më kosto-efektive: një lekë i investuar në reduktimin e rreziqeve të katastrofave mund të kursejë 2 deri në 10 lekë në koston totale të përgjigjes dhe rindërtimit pas katastrofës.⁵

Dhjetë tërmetet më shkatërrimtare në Shqipëri

1. ***17 tetor 1851, Rajoni i Beratit*** goditet nga një tërmet i fuqishëm me pasoja të rënda. Mbi 400 të vdekur dhe shkatërrime të shumta në ndërtesa. Plasaritje të mëdha, rrëshqitje toke dhe pluhur me sqfur.

⁵ISSAI 5510, The audit of disaster risk reduction, Paragraph B.2.

2. **Korrik-gusht 1855, Shkodra** ndjen lëkundje të forta që shkaktojnë shkatërrimin e Bushatit, Jubanit, Kozmaçit, Vaut të Dejës dhe fshatra të tjerë në Shkodër, Karmë, Dushan, Toplanë dhe Bruç. Çarje të mëdha në tokë.
3. **22 dhjetor 1919, Leskovik-Konicë** ndihet tërmeti 6.1 ballë i shkallës Rihter. Shumë shtëpi të shkatërruara brenda kufijve shqiptarë si dhe në fshatrat grekë Isboros, Plavoli, Belthonsi dhe Kapaztiko. I gjithë rajoni i shkatërruar. Nuk ka të dhëna për viktima.
4. **18 dhjetor 1920, Elbasanit** i shkatërrohen totalisht 173 shtëpi dhe dhjetëra persona plagosen. Pasojat e tërmetit me epiqendër në Elbasan më së shumti u ndjenë në Peqin, ku 14 persona humbën jetën dhe 300 të tjerë u plagosën rëndë.
5. **30 mars 1921**. Nuk ka të dhëna për dëme në njerëz, por dhjetëra shtëpi janë shkatërruar në Peshkopi dhe Dibër (Maqedoni).
6. **27 gusht 1948, Nën Shkodra** preket nga tërmeti 5.5 ballë. Dëmtime serioze të shtratit të lumit Buna dhe në qytetin e Shkodrës. Dëmet më të mëdha raportohen në Trush (1 i vdekur dhe 27 të plagosur). Shkatërrime objektesh ka pasur edhe në Oblikë e Barbullush.
7. **1 shtator 1959**, shkatërrime në Lushnje, Fier, Rrogozhinë, Peqin, Kuçovë dhe Berat. Në total 944 shtëpi të shkatërruara. Kryesisht në Karbunarë të Lushnjës. Dëmtime të mëdha në objekte industriale, shkolla, spitale dhe objekte kulturore. Çarje të tokave bujqësore.
8. **30 nëntor 1967, Librazhd-Dibër**, 6.6 ballë. Dëme të mëdha në 13 lokalitete dhe 177 fshatra. Së bashku me Maqedoninë e Veriut e prekur nga tërmeti raportohen 6336 ndërtesa të shkatërruara. Raportohet për 12 të vdekur dhe 174 të plagosur.
9. **15 prill 1979**, tërmeti 8 ballë godet Shkodrën, duke shkaktuar viktima dhe dëmtime të mëdha. Fatkeqësisht, 40 persona humbën jetën në Shkodër-Lezhë. U dëmtuan 17,118 shtëpi e objekte social-kulturore.
10. **9 janar 1988**, lëkundje të shpeshta në Tiranë me dëme materiale. Pasojat kryesore në fshatrat Arbanë dhe Petrelë.⁶

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performancë. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiensa dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022 për auditimet e performancës, si: *fokusimi në çështje makro-ekonomike, krahas atyre mikro-ekonomike apo fokusimi në auditime procesi më shumë sesa auditime institucioni*⁷, etj., KLSH ndërmori auditimin e Efektiviteti i programeve për përballimin e paosjave të fatkeqësisë natyrore 2019ö. Si një ndër çështjet dhe problematikat kryesore me të cilat vendi ynë është ballafaquar këto dy vitet e fundit, KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me efektivitetin dhe përdorimin e fondeve nga institucionet përgjegjëse sa i

⁶Guri. S., Drithërimat e tokës dhe të njeriut, Çahuhet dhe çamund të dimë për tërmetet, 2020, fq 139, 140.

⁷ Strategjia e Zhvillimit Institucional 2018-2022 KLSH, fq. 39

përket menaxhimit të situatës së post tërmetit të 2019, si dhe të japë rekomandime për të përmirësuar aty ku është e mundur.

SAI-t kanë një kontribut jetësor për të mbajtur në vëzhgim qeveritë të cilat menaxhojnë ndihmat lidhur me katastrofat natyrore duke i bërë ato më të përgjegjshme para parlamenteve dhe qytetarëve.⁸Vende të ndryshme hartojnë politika të menaxhimit të katastrofave për t'u mbështetur dhe për t'u ballafaquar me rrezikun që vjen prej katastrofave. Menaxhimi i katastrofave është një përgjegjësi që ndahet midis qeverive, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Koordinimi efektiv midis këtyre aktorëve të ndryshëm është një parakusht për menaxhimin me sukses të katastrofave.⁹

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Lidhur me tematika deri diku të ngjashme, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka realizuar disa auditime të ndryshme përgjatë viteve si më poshtë:

- Auditim performance me temë *ËPërmbytjet-Parandalimi, Mbrojtja, Gadishmëria* bazuar në programin e auditimit nr.786/6, datë 12.10.2018, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 224 datë 20.12.2018. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile.
- Auditim performance me temë *ËSigurimi i cilësisë së veprave ndërtimore* bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit sipas shkresës nr.prot.1006/1, datë 31.12.2018 dhe shkresës nr.1006/5/6/7/8, datë 12.07.2019, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 114, datë 30.09.2019. Ky auditim u ushtrua në Institutin e Ndërtimit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit.
- Auditim i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile *ËMbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit sipas Programit të auditimit nr. 68/3, datë 11.02.2020, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 72, datë 25.06.2020.*

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Ministria e Shtetit për Rindërtim
2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë
3. Bashkia Tiranë
4. Bashkia Durrës
5. Agjencia Kombëtare e Planifimit të Territorit
6. Fondi Shqiptar i Zhvillimit
7. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

1. **Ministri i Shtetit për Rindërtim**, si pjesë përbërëse e infrastrukturës për rindërtimin, i cili vepron në përputhje me detyrat dhe të drejtat e parashikuara në Ligjin nr. 9000/2003, *ËPër organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave*, si dhe VKM nr. 11, datë 10.1.2020 *ËPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin*.

2. **Ministria e Financës dhe Ekonomisë** nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit është e angazhuar në ndjekjen e zërit Fondi i Rindërtimit nga pikëpamja e detajimit/çeljes së tij në zbatim të VKM-ve të miratuara për këtë qëllim. Misioni i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është arritja e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me eficiencë, efektivitet dhe transparencë të financave publike.

⁸ISSAI 5520, Audit of Disaster related aid, paragraph 1.3

⁹ISSAI 5520, Audit of Disaster related aid, paragraph 3.6

3. **Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)** bazohet në Ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 *ËPër planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritë i ndryshuar dhe në VKM nr. 427, datë 08.06.2016 ËPër organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territoritë.* Ajo bashkërendon proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit e zhvillimit të territorit dhe mbështet bashkërendimin vertikal e horizontal ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit. AKPT-ja udhëheq, koordinon dhe ndërlidh veprimtaritë për modernizimin e modelit të planifikimit dhe promovimin e praktikave novatore në arkitekturë e planifikim. AKPT është ngarkuar që të jetë pjesë në skemën kombëtare të rindërtimit me VKM nr. 9, datë 10.01.2020 *ËPër caktimin e njërive zbatuese për hartimin e planeve të detyruara vendore dhe financimin e tyre për rindërtimin, miratuar në buxhetin e vitit 2020.*

4. **Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)** është krijuar me Ligjin nr. 10130, datë 11.05.2009 *ËPër Fondin Shqiptar të Zhvillimitë, si një organizatë që ka objekt të veprimtarisë nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit, duke gëzuar statusin e një organizate jofitimprurëse me pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike. FSHZH-ja e ushtron veprimtarinë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me statutin, manualin e procedurave, si dhe me kushtet e përcaktuara në marrëveshjet e financimit dhe të zbatimit të projekteve. Duke qënë se FSHZH ka qënë në rolin e agjencisë zbatuese në shumë programe të rëndësishme të zhvilluara në Republikën e Shqipërisë duke dëshmuar se funksionon dhe operon me efektivitet, referuar Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 *ËPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreë, neni 16, pika 1 ajo është përcaktuar në cilësinë e njësisë zbatuese krahas njësive te tjera duke mbuluar sipas rastit disa nga aspektet e procesit të rindërtimit(projektim dhe rindërtim të disa tipologjive të caktuara objektesh dhe infrastrukturë).**

5 & 6. **Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës** në zbatim të kompetencave sipas përcaktimeve në legjislationin në fuqi për mbrojtjen civile dhe për planifikimin dhe zhvillimin e territorit si njësi zbatuese nëpërmjet programit të rindërtimit:

a) administrojnë fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave prej fondit të rindërtimit, përfshi dhe kontributet në natyrë, kur caktohen si njësi zbatuese me Vendim të Këshillit të Ministrave;

b) miratojnë planet e detyruara vendore, planet e detajuara vendore dhe lejet e zhvillimit e të ndërtimit, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktin normativ nr.9 datë 16.12.2019;


c) krijojnë, administrojnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave për individët dhe familjet që kanë humbur familjarë dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe plotësimin e nevojave të tyre nga programet e procesit të rindërtimit¹⁰.

7. **Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)** është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 45, datë 18.7.2019 *ËPër Mbrojtjen Civileë, VKM nr. 747, datë 20.11.2019 ËPër organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civileë, si dhe Urdhri i Kryeministrit nr. 27, datë 3.2.2020 ËPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civileë, si strukturë përgjegjëse për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.* AKMC si pjesë përbërëse e strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes e cila mbledh, menaxhon, përpunon dhe analizon të gjitha aktet e vlerësimit paraprak, aktekspertizat e thelluara dhe çdo të dhënë tjetër mbi pasojat e fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësive të tjera, që i përcillen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet e tjera shtetërore. AKMC-ja mund verifikojë aktet e vlerësimit paraprak, aktekspertizat e thelluara, si dhe të dhënat e tjera të përcjella nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet e tjera shtetërore, si dhe mund të kërkojë informacione shtesë mbi këto të dhëna nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo autoritetet e tjera shtetërore ose drejtpërdrejt nga subjektet e interesuara. AKMC-ja vepron si sekretariat teknik i Komisionit

¹⁰ Akti normativ nr.9 datë 16.12.2019 *ËPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreë, neni 17.*

Shtetëror të Rindërtimit dhe mbështet Komisionin për përmbushjen e detyrave të parashikuara nga ky akt normativ.¹¹

Fig. 1 Skema e aplikimit dhe përfitimit të fondeve të rindërtimit lidhur me tërmetin:



Punoi: Grupi i auditimit

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

- Ligji Nr. 154/2014, *“Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të Shtetit”*
- Ligji Nr.44/2015 *“ Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Ligji Nr. 139/2015 *“ Për vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë”*.
- Ligji Nr. 45/2019 *“Për mbrojtjen civile”*.
- Ligji Nr. 97/2019 *“Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, të Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe akte të tjera normative me fuqinë e ligjit në funksion të rindërtimit”*.
- Ligji Nr. 107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit të ndryshuar”*.
- Ligji Nr.1013, datë 11.05.2009 *“Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”*.
- Ligji Nr.9936.datë, 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*.
- Ligji Nr. 73, datë 04/11/2019 *“Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 2 datë 2.10.2019 të KM për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018 për buxhetin e shtetit të vitit 2019”*.
- Ligji Nr.88/2019 *“Për Buxhetin e vitit 2020”*.

¹¹Akti normativ nr.9 datë 16.12. 2019 *“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 15”*.

-Ligji Nr,137.datë,16.11.2020 *öPër buxhetin e shtetit 2021ö.*

-Ligji Nr. 107/2014, *öPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritö.*

- Ligji Nr. 96/2019 *öPër miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 8 dt 16.12.2019 të KM “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasëö.*
Akti normativ nr.8 datë 16.12.2019 të KM *öPër përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasëö.*

-VKM Nr. 9, datë, 10.01.2020 *öPër caktimin e njësave zbatuese për hatimin e planeve të detyruara vendore dhe financimin e tyre nga fondi për rindërtimin, miratuar në buxhetin e vitit 2020ö.*

-VKM Nr.5., datë 06.01.2020, *“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet modelö, i ndryshuar.*

-VKM Nr.750, datë 27.11.2019 *öPër shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranëö.*

-VKM Nr.878,datë 24.12.2019,*öPër përbërjen,organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitö.*

-VKM Nr. 835, datë 3 Dhjetor 2004 për *öPlanin Kombëtar të Emergjencave Civileö.*

-VKM Nr.887, datë 24.12.2019 *öPër përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyroreö.*

-VKM Nr.714 ,datë 10.09.2020 *öPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 887, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyroreö.*

-VKM Nr.686 , datë 22.11.2017 *öPër miratimin e rregullores së planifikimit të territoritö.*

-VKM Nr. 796, datë 11.12.2019 për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, *öPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritö, të ndryshuarö.*

-VKM Nr.750, datë 27.11.2019 *öPër shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore ne qarqet Durrës dhe Tiranë”.*

-VKM Nr.354.,datë 11.05.2016 *öPër miratim manuali të tarifave për sherbime ne planifikim territori,projektim,mbikqyrje,kualidim”.*

-VKM Nr.1, datë 07.01.2020 i KSHR *öPër konstituimin e KSHR si organ publik etjö.*

- VKM Nr. 11, datë 10.1.2020 *öPër përcaktimin e fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë të Shtetit për rindërtimö.*

VKM Nr. 923, datë 25.11.2020 *öPër funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstytucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civileö.*

VKM Nr. 904, datë 24.12.2019 *öPër përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare,masës së përfitimit,autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimitö.*

-VKM Nr. 1020 datë 16.12.2020 *öPër përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësiveö.*

-VKM Nr. 747, datë 20.11.2019 *öPër organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civileö*

-VKM Nr.26, datë 15.1.2020 *ö Për kryerjen e Aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuaraö .*

- Urdhër i Kryeministrit nr. 160, datë 20.11.2019 *öPër ngritjen e Komitetit Kombëtar për hartimin e programit për rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”.*

-Urdhër i Kryeministrit nr. 27, datë 3.2.2020 *öPër miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civileö.*

-Urdhër nr.61 datë 12.05.2017 *öPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territoritö.*

-Urdhër nr.42 datë 02.03.2020 *öPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë*

Kombëtare të Planifikimit të Territoritë.

-Urdhër nr.45 datë 05.03.2020 *Ë Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për tërheqjen e donacioneve në kuadër të procesit të rindërtimitit.*

-Udhëzimi nr.03, datë 08.12.2019 i Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile *Ë Për bashkërendimin e veprimeve për vlerësimin e dëmeve në ndertesa në mënyrë të unifikuarë.*

-Urdhër nr.1, datë 08.12.2019 i Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile *Ë Për mënyrën e mbledhjes së të dhënave lidhur me gjendjen e ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”.*

- Urdhër nr.4, datë 15.12.2019 i Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile *Ë Për angazhimin e inxhinierëve dhe të arkitektëve në kuadër të operacioneve të vlerësimit të objekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.12.2019ë.*

-Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr.57, datë 01.06.2020 *Ë Për përcaktimin e masës së vlerës së rikonstruksionit ose riparimit dhe miratimin e udhëzuesitë,për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionitë*

-Urdhër i AKPT nr.17, datë 15.02.2018, *Ë Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territoritë.*

Urdher Nr.86, i AKPT, datë 10.07.2020,*Ë Për një ndryshim në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territoritë,miratuar me Urdhërin nr.17 datë 15.02.2018.*

-Urdhër i Bashkisë Durrës nr.108,datë 12.08.2020 *Ë Për ngritjen e zyrës së posaçme të rindërtimit, rikonstruksionit dhe rimëkëmbjes ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”.*

-Vendim i Bashkisë Durrës nr. 66, datë 07.05.2019 *Ë Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores se Bashkisë Durrësë.*

-Vendim i Bashkisë Durrës nr.583, datë 24.06.2020 *Ë Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrësë.*

-Vendim i Bashkisë Durrës nr.29, datë 09.04.2021 *Ë Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrësë.*

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Ministrit të Mbrojtjes, dhe Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave vendosi miratimin e ***Aktit Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”***. Ky akt rregullon funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

1. Procesi i rindërtimit është një proces i integruar zhvillimi i përbërë nga disa programe, në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të shëndetit pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

2. Programi i zhvillimit të objekteve të reja që përbëhet nga këto nënprograme:

a) Zhvillimi i objekteve të reja dhe i zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publikepërkatëse, si dhe rikonstruksioni i ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe të infrastrukturës publikenga autoritetet shtetërore;

b) Zhvillimi i objekteve të reja dhe zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publikepërkatëse, si dhe rikonstruksioni i ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe i infrastrukturës publike,nga autoritetet shtetërore nga donatorët;

c) Rindërtimi i ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall;

ç) Programi i bashkëpunimit për ndërtime në bashkëpunim me sektorin privat.

3. Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike kur nuk është pjesë e programeve të tjera të parashikuara në këtë ligj, dhe të infrastrukturës kritike është programi me anë të të cilit me

financim nga fondi i rindërtimit apo nga donatorët ndërtohen ose rikonstruktohen objekte të infrastrukturës publike dhe kritike nga njësitë zbatuese.

4. Programi i krijimit të fondit të banesave përbëhet nga:

- a) Programi i blerjes së banesave të reja në treg të lirë;
- b) Programi i banesave të dhuruara nga subjektet private.

5. Programi i granteve të rindërtimit përbëhet nga:

- a) Granti për rindërtimin ose rikonstrukcionin e banesave të dëmtuara;
- b) Pagesa e qirasë për familjet e mbetura të pastreha nga fatkeqësia natyrore;
- c) Kompensimi i shpenzimeve të subjekteve të sektorit privat që ofrojnë struktura akomoduese për familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore.

6. Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike që përbëhet nga këto nënprograme:

- a) Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësia natyrore;
- b) Masat për rimëkëmbjen sociale;
- c) Masat për rimëkëmbjen ekonomike;
- ç) Masat rikuperuese dhe parandaluese.

7. Kushtet, kriteret, kategoritë prioritare, procedurat dhe rregullat për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, përfshirë dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfituesit nuk mund të përfitojnë në të njëjtën kohë nga më shumë se një program i procesit të rindërtimit për qëllim strehimi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë akt. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që subjektet të cilat nuk përfitojnë nga një program i caktuar, të kenë mundësi për të kaluar në një program tjetër të procesit të rindërtimit, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave. Subjektet përfituese nga programet e procesit të rindërtimit konsiderohen që shpërblehen, jo më shumë se vlera e dëmit real të përbërë nga humbja e pësuar e jetës së njeriut dhe/ose vlera e dëmeve pasurore.

8. Kriteret e përparësisë për renditjen e përfituesve janë:

- a) familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore;
- b) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
- c) familjet që kanë në përbërje personat me aftësi të kufizuara;
- ç) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit;
- d) familjet në skemën e ndihmës ekonomike;
- dh) të rënë në krye të detyrës¹².

Vlerësimi i nevojave Post Shkatërrim (Post-Disaster Needs Assessment) është dokumenti i vetëm i cili ka përllogaritur me përafërsi kostot e dëmeve të tërmetit të 26 nëntorit të 2019. Ai është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit të Qeverisë së Shqipërisë, Bashkimit Evropian, Agjencive të Kombeve të Bashkuara dhe Bankës Botërore. Metodologjia e vlerësimit përfshiu të dhëna primare dhe sekondare nga njësi dhe burime të ndryshme private dhe publike, të cilat u verifikuan edhe me vizita në terren aty ku ishte e mundur. Veç kësaj, u kryen vëzhgime të ndryshme të strukturuar si për shembull vëzhgime të ndërtesave, biznesit, jetesës - drejtuar njerëzve të zhvendosur në hotele dhe çadra referuar si anketa mbi dëmet e familjeve për shkak të tërmetit. Përllogaritja e dëmeve është bërë sipas sektorëve të ndryshëm në 11 prej bashkive (Tiranë, Durrës, Shijak, Krujë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Kurbin, Mirditë) më të prekura nga ky tërmet. Siç u përmend edhe në nënkapitullin 1.1, vlera totale e dëmeve të përllogaritura nga tërmeti i 26 nëntorit të 2019 është rreth 1 miliardë euro, e ndarë kjo në sektorë dhe nënsektorë ku sektori më i prekur ishte ai i banesave.

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC) është dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e emergjencave civile. Ai është hartuar në mbështetje të Ligjit nr.

¹²Akti Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 18.

8756, datë 26 mars 2001, òPër emergjencat civileò dhe të ligjeve të tjera që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me emergjencat civile dhe është miratuar me VKM nr. 835, datë 03.12.2004. PKEC-ja shërben si një manual ku përmbledhen informacione, në të cilin janë përshkruar faktorët më të rëndësishëm dhe rolet e të gjitha institucioneve dhe të strukturave të përfshira në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave civile. PKEC-ja nuk do të jetë asnjëherë plotësisht i përfunduar ose i mbyllur. *Ai duhet të rishikohet e të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar bashkëpunimin e përhershëm dhe ndryshimet në nevoja dhe burime të Shqipërisë.* Fuqia e PKEC-së qëndron në bashkëpunimin dhe konsensusin e të gjitha institucioneve dhe strukturave, për të zvogëluar rreziqet, për të shpëtuar jetë njerëzore dhe për të minimizuar dëmtimet që vijnë si rrjedhojë e emergjencave civile në Shqipëri. Duke mbledhur së bashku dhe duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve, strukturaveshtetërore dhe shoqërisë civile, nëpërmjet PKEC-së synohet:

- Të parandalohet, të lehtësohet dhe të riaftësohet nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë egjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.
- Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjence civile.
- Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme të shtetit me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.¹³

Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile i cili referuar Ligjit nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civileò neni 19, ka një sërë detyrimesh dhe përgjegjësisish për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve publike. Ai ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore si për shembull:

- Urdhëri nr. 1, datë 08.12.2019 òPër mënyrën e mbledhjes së të dhënave lidhur me gjendjen e ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019ò i cili ka përcaktuar Akt Konstatimin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara. Në pikën 3 të këtij urdhëri citohet që duke filluar nga data 08.12.2019, ndërpritet dokumentimi i vlerësimit të dëmeve të tërmetit në ndërtesa duke përdorur formularë të tjerë, duke përfshirë edhe formularët që janë përdorur deri më datë 07.12.2019.
- Udhëzim nr. 3 datë 08.12.2019 òPër bashkërendimin e veprimeve për vlerësimin e dëmeve në ndërtesa në mënyrë të unifikuar.
- Urdhër nr. 4 datë 15.12.2019 òPër angazhimin e inxhinierëve dhe arkitektëve në kuadër të operacioneve të vlerësimit të objekteve të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.

Me anë të VKM-së nr. 878 datë 24.12.2019 Këshilli i Ministrave vendosi òPërbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò. Sipas kësaj VKM-je, (Kreu V, pika 4) Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile u zëvendësua me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit.

2.4 Peshë në buxhet dhe PBB

Pas fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i muajve shtator, nëntor 2019, nga Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit janë akorduar fonde për procesin e rindërtimit rreth 540 milionë lekë, nga të cilat 200 milionë për investime dhe 340 milionë për shpenzime korrente. Në vitin 2020, Ligji nr.88/2019 òPër Buxhetin e vitit 2020ò miratoi Fondin e Rindërtimit në masën 20 miliardë lekë në nivel total vjetor, ndërkohë që në nenin 7 të këtij ligji përcaktohet përdorimi i tij si më poshtë:

¹³Plani Kombëtar i Emergjencave Civile fq 7&8.

oFondi i Rindërtimit prej 20 miliardë lekë, i cili përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, përbëhet nga:

- Grante 7 miliardë lekë.
- Shpenzime të buxhetit të shtetit 13 miliardë lekë.

Vlera prej 20 miliardë lekë e përcaktuar si Fond i Rindërtimit, me ndryshimet e akteve ligjore gjatë vitit 2020 arriti në vlerën 32 miliardë lekë.¹⁴

Konkretisht nëpërmjet Aktit Normativ nr. 34/2020, datë 16.12.2020 oPër disa ndryshime në Ligjin nr. 88/2019 Për buxhetin e vitit 2020o, janë miratuar Fondet e Rindërtimit gjithsej për 32 miliardë lekë i ndarë si më poshtë:

- Grante 3 miliardë lekë.
- Shpenzime të buxhetit të shtetit 29 miliardë lekë.

Gjithashtu në zbatim të Ligjit oPër buxhetin e vitit 2020o, të ndryshuar dhe përcaktimeve për Fondin e Rindërtimit si më sipër, në Udhëzimin Plotësues nr.2, datë 20.01.2020, në paragrafin 27 është përcaktuar:

oFondi i Rindërtimit do të përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019. Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do të alokohet fondi si dhe institucionet dhe agjencitë, zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen në vitin pasardhës dhe do të përdoren për të njëjtin qëllim.o

Nga fondi i planifikuar për vitin 2020 prej 29,000,000,000lekësh nga Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit, janë akorduar 25,764,375,000 lekë. Nga këto:

- 404,089,000lekë janë akorduar për shpenzime korrente për Njësitë e Qeverisjes Qendrore.
- 10,451,539,000 lekë janë akorduar shpenzime për investime për Njësitë e Qeverisjes Qendrore.
- 14,908,747,000 lekë janë akorduar si trasfertë e pakushtëzuar për Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Nga fondet grante të parashikuara prej 3 miliardë lekësh janë shpërndarë në zbatim te VKM-ve rreth 688,262,000 lekë .

Për vitin 2021 në Ligjin e Buxhetit Nr. 137/2020 oPër buxhetin e vitit 2021o, është përcaktuar: *“Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 28,000 milionë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara në vitin 2020, si dhe për projektet e reja. Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen në vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim”*. Në zbatim të përcaktimit të Ligjit të Buxhetit Nr. 137/2020 oPër buxhetin e vitit 2021o, në Udhëzimin Plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 oPër buxhetin e vitit 2021o, në pikën 12.d të tij është përcaktuar procedura e përdorimit të fondeve të rindërtimit dhe mbartja e tyre. Nga të dhënat e MFE dhe referuar Ligjit nr.88/2019 oPër buxhetin e vitit 2020o, të ndryshuar dhe Ligjit Nr. 137/2020 oPër buxhetin e vitit 2021o, Fondi i Rindërtimit (planifikimi) paraqitet si më poshtë në raport me totalin e shpenzimeve në Buxhetin e Shtetit:

Tabela nr. 3

	Viti 2020 Plani /Lekë	Viti 2021 Plani/Lekë
Grante/Donacione	3,000,000,000	
Buxheti i Shtetit	29,000,000,000	18,118,126,000


¹⁴Akti Normativ nr. 34/2020, datë 16.12.2020 oPër disa ndryshime në Ligjin nr. 88/2019 Për buxhetin e vitit 2020

Financime të mbartura		9,881,874,000
Fondi i Rindërtimit total	32,000,000,000	28,000,000,000
Buxheti i Shtetit Total shpenzime	539,374,000,000	592,801,000,000

Burimi: MFE. Përpunoi: Grupi i auditimit

Pesha specifike që zë Fondi i Rindërtimit në totalin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit për vitin 2020 është rreth 5.9% (e ilustruar kjo në Grafikon nr. 1).


Grafiku nr. 1 Pesha specifike e fondit të rindërtimit për vitin 2020 në raport me totalin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit



Burimi: MFE. Përpunoi: Grupi i auditimit

Pesha specifike që zë Fondi i Rindërtimit në totalin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit për vitin 2021 është rreth 4.7% (e ilustruar kjo në Grafikon nr. 2).

Grafiku nr. 2 Pesha specifike e fondit të rindërtimit për vitin 2021 në raport me totalin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit



Burimi: Grupi i auditimit

Referuar Aktit Normativ nr. 9, datë 08/06/2017 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, Neni 16, ÷Njësia zbatuese administron fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave prej fondit të rindërtimit. Subjektet nën auditim, konsideruar si njësi zbatuese, në zbatim të VKM-ve përkatëse kanë përfituar fonde gjatë periudhës objekt auditimi si më poshtë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

FSHZH nëpërmjet Vendimeve të Këshillit të Ministrave është angazhuar rast pas rasti si njësi zbatuese për programin e rindërtimit për komponentët e projektimit, rindërtimit dhe rikonstruksionin të objekteve arsimore, rindërtimin e shtëpive individuale, infrastrukturës publike si dhe njërive të banimit në pallat. Buxheti i alokuar gjatë periudhës objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 4 Fondi për Rindërtimin/Lekë (Periudha Janar 2020-30.04.2021)

Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Buxheti i alokuar sipas VKm-ve perkatëse	Fond shpenzuar	Fond i mbetur
Fondi i rindërtimit viti 2020	9,907,591,024	6,824,263,928	3,083,327,094
Fondi i rindërtimit viti 2021	4,255,771,700	1,699,961,333	2,555,810,367

Burimi : FSHZH-MFE

Bashkia Tiranë

Bashkia Tiranë është caktuar si njësi zbatuese për hartimin e planit të detyruar vendor për Bashkinë Tiranë dhe rindërtimin e një sërë objektesh brenda territorit të saj. Për periudhën objekt auditimi fondet e alokuara nga fondi i rindërtimit paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 5 Fondi për Rindërtimin/Lekë (Periudha Janar 2020-30.04.2021)

Bashkia Tiranë	Buxheti i alokuar sipas VKm-ve perkatëse	Fond shpenzuar	Fond i mbetur
Fondi i rindërtimit viti 2020	5,919,649,980	2,154,086,563	3,765,563,417
Fondi i rindërtimit viti 2021	12,839,604,970	1,836,319,075	11,003,285,895

Burimi : Bashkia Tiranë-MFE

Bashkia Durrës

Bashkia Durrës ka përfituar nga fondet e rindërtimit për periudhën 2020-2021, si më poshtë:

Tabela nr. 6 Fondi për Rindërtimin/Lekë (Periudha Janar 2020-30.04.2021)

Bashkia Durrës	Buxheti i alokuar sipas VKm-ve perkatëse	Fond shpenzuar	Fond i mbetur
Fondi i rindërtimit viti 2020	5,078,474,339	3,708,237,149	1,370,237,190
Fondi i rindërtimit viti 2021	2,769,491,475	1,365,220,145	1,404,271,330

Burimi : Bashkia Durrës-MFE

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

Agjencia e Planifikimit të Territorit (me VKM Nr. 9, datë 10.1.2020) për caktimin e njërive zbatuese për hartimin e planeve të detyruara vendore dhe financimin e tyre nga fondi për rindërtimin, miratuar në buxhetin e vitit 2020 është caktuar njësi zbatuese, për hartimin e planeve të detyruara vendore për 9 bashki: Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak, Vorë.

Tabela nr. 7 Fondi për Rindërtimin/Lekë (Periudha Janar 2020-30.04.2021)

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	Buxheti i alokuar sipas VKM-ve perkatëse	Fond shpenzuar	Fond i mbetur
---	--	----------------	---------------

Fondi i rindërtimit viti 2020	137,420,000	89,467,590	47,952,410
Fondi i rindërtimit viti 2021	47,952,410	3,272,000	44,680,410

Burimi : AKPT-MFE

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

AKMC nuk ka financime nga fondi i rindërtimit për periudhën 2019-2021. Bazuar në VKM nr. 750, datë 27.11.2019, ÷Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë, Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ÷Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, si dhe aktet e tjera, menaxhimi i situatës së krijuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 u realizua nga Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile dhe nga organet përgjegjëse, funksioni i të cilave është rregulluar kryesisht përmes këtyre akteve ligjore, por edhe akteve të tjera.

Vlera totale e dëmit dhe humbjeve të përlogaritura në 11 bashki nga PDNA (*Post Disaster Needs Assessment*) është 121.1 miliardë lekë ndarë sipas sektorëve. Bashkitë më të dëmtuara janë Durrësi (31.5%) dhe Tirana (30.8%).¹⁵

Raporti i fondeve të alokuara gjatë viteve 2020-2021 me vlerën totale të dëmit të përlogaritur nga PDNA paraqitet si më poshtë në /000 lekë:

Vlera totale e dëmit të përlogaritur nga PDNA 121,210,000,000 lekë.

Fondi i rindërtimit i planifikuar në vitin 2020 32,000,000,000 lekë ose 26% e totalit të PDNA.

Fondi i rindërtimit i planifikuar në vitin 2021 28,000,000,000 lekë ose 23% e totalit të PDNA.


Tabela nr. 8 *Fondi i rindërtimit i planifikuar për periudhën 2020-2021 në raport me vlerën totale të dëmit përcaktuar nga PDNA*

Emërtimi	000/lekë	Raporti (%) me vlerën totale të dëmit
Vlera totale e dëmit PDNA	121,210,000	100%
Fondi i rindërtimit i planifikuar viti 2020	32,000,000	26%
Fondi i rindërtimit i planifikuar viti 2021	28,000,000	23%

Burimi: PDNA MFE

¹⁵PDNA Shkurt 2020 (Total Damages and Losses), fq 8.

Grafiku nr. 3 Pesha specifike e fondit të rindërtimit të planifikuar për vitet 2020-2021, në raport me vlerën totale të dëmit



Burimi MFE, PDNA

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

• **Banesë**, një ndërtesë ose një njësi banimi brenda një ndërtese që përbëhet nga bashkësia e mjediseve ose mjedisi i vetëm që ka hyrje të pavarur dhe dalje në kat, oborr, tarracë ose rrugë e destinuar për banim. • **Donacion**, akti i ofrimit të mjeteve financiare ose i kontributeve në natyrë, apo asistencë teknike në mënyrë vullnetare nga donatorët.

• **Donatorë**, janë individët, personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, qeveritë e shteteve të huaja, institucionet bankare dhe institucionet financiare jobankare, organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, organizmat ndërkombëtarë, që kontribuojnë në mjete financiare ose në natyrë, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të aktit normativ nr. 9 datë 16.12. 2019 •Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

• **Familje**, konsiderohen individët që rezultojnë në përbërjen familjare sipas të dhënave në regjistrin e gjendjes civile përkatëse.

• **Marrëveshje kuadër**, marrëveshja që lidhet me operatorët ekonomikë, në përfundim të fazës së parë kualifikuese, për secilën procedurë prokurimi publik të procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të aktit normativ nr. 9 datë 16.12. 2019 •Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

• **Njësi zbatuese**, një ose disa organe publike të ngarkuara nga Këshilli i Ministrave për administrimin e fondeve të transferuara nga fondi i rindërtimit, si dhe për kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në Aktin normativ nr. 9 datë 16.12. 2019 •Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

• **Prokurimi publik për rindërtimin**, procesi i përshpejtuar i prokurimit që zbatojnë autoritetet kontraktore për përzgjedhjen e fituesve për kontratat publike për mallra, punë dhe shërbime, në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit, në përputhje me parashikimet e aktit normativ nr. 9/2019 dhe të ligjit për prokurimin publik, për aq sa nuk bie në kundërshtim me parashikimet e aktit normativ nr. 9 datë 16.12. 2019 •Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

• **Plan i detyruar vendor**, dokument planifikimi që hartojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet përgjegjëse, sipas rastit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe, kur çmohet e nevojshme, për të garantuar sigurinë e jetës dhe shëndetit, që përcakton kushtet për zhvillim të detyruar, si dhe zhvillimin e zonave të reja.

• **Prishje e detyruar**, procesi i shembjes së një ndërtese apo disa ndërtesave, në pronësi private apo publike, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, që përbëjnë rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe që nuk mund të riparohen, siç vërtetohet nga aktekspertiza e thelluar.

•**Ndërtesë e dëmtuar**o, çdo ndërtesë, në pronësi publike apo private, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, që përbën rrezik për jetën e shëndetin e njerëzve dhe që nuk mund të riparohet.

•**Zonë e dëmtuar**o, territori që përfshin një ose disa ndërtesa, infrastruktura publike apo edhe infrastrukturë kritike të dëmtuar.

•**Akt-ekspertizë e thelluar**o, është akti që lëshon çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, nga ndërtesa apo grupi i ndërtesave të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, si dhe ku rekomandohen masat që duhen marrë sipas parashikimeve në ligj.

•**Infrastrukturë publike**o, janë ndërtesat në pronësi publike, si dhe rrugët, sheshet, parqet apo hapësira të ngjashme publike, të ndryshme nga infrastruktura kritike.

•**Infrastrukturë kritike**o, janë strukturat fizike, rrjetet dhe pasuritë e tjera, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin ekonomik e social të shoqërisë ose të komunitetit, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 45/2019, *“Për mbrojtjen civile*o.

•**Zhvillim i detyruar**o, e drejta e autoritetit përgjegjës për të vendosur prishjen e ndërtesave dhe zhvillimin e territorit ku ndodhen ndërtesa apo një grup ndërtesash, në pronësi publike apo private, si rezultat i dëmtimit të tyre nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore dhe që rrezikon jetën e shëndetin e banorëve, si dhe për zhvillimin e zonës së re në përputhje me planin e detyruar vendor, sipas parashikimeve të Aktit normativ nr.9 datë 16.12. 2019 *“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore*o.

•**Zonë e re për zhvillim**o, territori që përcaktohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligj.¹⁶

“Baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë” sht grumbullimi i organizuar i informacionit në mënyrë sistematike, në lidhje me fatkeqësitë, dëmet, humbjet dhe impaktet e tyre.

“Emergjencë civile” sht situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

“Fatkeqësi natyrore” jan fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

•**Gjendja e fatkeqësisë natyrore**o sht gjendja e vendosur nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Kushtetutën dhe legjisllacionin në fuqi për mbrojtjen civile, në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose të fatkeqësive të tjera.

“Gatishmëri” jan njohuritë e kapacitetet e zhvilluara nga sistemi i mbrojtjes civile dhe komuniteti, për të parashikuar, për t’u përgjigjur dhe për t’u rimëkëmbur në mënyrë efektive nga impaktet e fatkeqësive të mundshme, të afërta apo reale.

“Kapacitet” sht kombinimi i të gjitha forcave, atributeve dhe burimeve brenda një komuniteti, shoqërie apo organizate për të menaxhuar e për të zvogëluar risqet dhe për të forcuar aftësinë ripërtëritëse.

“Kapacitet përballues” sht aftësia e njerëzve, organizatave dhe sistemeve që përdorin aftësitë dhe burimet në dispozicion të tyre, për t’u përballur dhe për të menaxhuar kushtet e pafavorshme, emergjencat apo fatkeqësitë.

“Mbrojtja civile” sht tërësia e masave të marra për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me

¹⁶Të gjitha përkufizimet e mësipërme janë bazuar në Nenin 4 *“Përkufizimet*o të Aktit normativ nr.9 datë 16.12. 2019 *“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore*o.

qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.

“Menaxhimi i fatkeqësive” sht organizimi, planifikimi dhe zbatimi i masave të përgatitjes, përgjigjes ndaj fatkeqësive dhe të rimëkëmbjes prej tyre.

“Menaxhimi i emergjencave” sht organizimi dhe menaxhimi i burimeve dhe përgjegjësive për trajtimin e të gjitha aspekteve të emergjencave, në veçanti të gatishmërisë, të përgjigjes dhe të hapave fillestarë të rimëkëmbjes.

“Menaxhim i riskut nga fatkeqësitë” sht zbatimi i politikave dhe i strategjive për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, për të parandaluar riskun e ri nga fatkeqësitë, për të zvogëluar riskun ekzistues të fatkeqësive dhe për të menaxhuar riskun e mbetur, duke kontribuar në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe zvogëlimin e humbjeve të fatkeqësive.

“Ndërgjegjësimi publik” sht përhapja e njohurive, në lidhje me risqet nga fatkeqësitë, e faktorëve që çojnë në fatkeqësi dhe e veprimeve që mund të ndërmerren individualisht dhe kolektivisht për të zvogëluar ekspozimin e cënueshmërinë ndaj rreziqeve.

“Operacion ndërhyrjeje” jan veprime të veçanta dhe të koordinuara të institucioneve, të strukturave dhe të subjekteve, publike e private, për shpëtimin e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, në një territor të prekur nga fatkeqësia, si dhe sigurimi i kushteve për jetesë të komunitetit të prekur.

“Parandalim” jan aktivitetet dhe masat për shmangien e plotë të risqeve të fatkeqësive ekzistuese dhe atyre të reja.

“Parashikim” sht një deklaratë e caktuar ose vlerësim statistikor i ndodhjes së mundshme të një ngjarjeje të ardhshme të rrezikshme apo kushteve për një zonë të caktuar.

“Përgjigje” sht ofrimi i shërbimeve emergjente dhe të asistencës para dhe gjatë një fatkeqësie ose menjëherë pas saj, për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesë të njerëzve të prekur.

“Plani për emergjencën civile” sht plani për përgatitjen, parandalimin, mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të një fatkeqësie natyrore ose të një fatkeqësie tjetër, i hartuar në bazë të vlerësimit të risqeve dhe të gjetjeve të ekspertëve.

“Rehabilitim” sht rivendosja e shërbimeve dhe e strukturave themelore për funksionimin e një komuniteti ose një shoqërie të prekur nga një fatkeqësi.

“Rimëkëmbja” sht rivendosja ose përmirësimi i mjeteve të jetesës dhe të shëndetit, aseteve ekonomike, fizike, shoqërore, kulturore dhe mjedisore, sistemeve dhe aktiviteteve të një komuniteti ose shoqërie të prekur nga fatkeqësitë, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konceptit òrindërto më mirë, për të shmangur ose zvogëluar riskun e fatkeqësive të ardhshme.

“Rindërto më mirë” sht koncepti i përdorimit të fazave të rimëkëmbjes, rehabilitimit dhe rindërtimit pas një fatkeqësie për të rritur aftësinë ripërtëritëse të kombeve dhe të komuniteteve nëpërmjet masave të integruara të zvogëlimin të riskut të fatkeqësive në restaurimin e infrastrukturës fizike dhe të sistemeve shoqërore dhe në rijetësimin e mjeteve të jetesës, ekonomive e mjedisit.

“Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë” ka për qëllim parandalimin e risqeve të reja të fatkeqësive, zvogëlimin e atyre ekzistuese dhe menaxhimin e riskut të mbetur, që të gjitha së bashku ndihmojnë në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe si rezultat në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.


“Zhvillimi i qëndrueshëm” sht zhvillimi që plotëson nevojat aktuale pa kompromentuar aftësinë e gjeneratave të ardhshme për të përmbushur nevojat e tyre.

2.6 Skema e analizës së programit auditues

Ky auditim do të fokusohet në analizimin e efektivitetit të programeve për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, rolin që subjektet nën auditim kanë patur në nivel politikëbërje dhe në zbatim të funksionit të tyre duke u fokusuar veçanërisht në:

- zbatimin e programeve për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore;
- ndarjen e roleve ndërmjet subjekteve;
- mënyrat e përfitimit të fondeve të rindërtimit;
- krijimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave të nevojshme;
- monitorimin e procesit;
- transparenca me publikun;

Figura 2. Modeli input-output



2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore

Gjatë fazës studimore dhe të hartimit të projekt raportit të auditimit, stafet përgjegjëse të MSHR, MFE, AKPT, Bashkisë Tiranë dhe Durrës, si dhe FSHZH i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese, ndërsa për plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave plotësuese mbi subjektet, kërkuar më shumë kohë në përgjigjet e tyre kjo edhe për shkak të kompleksitetit të çështjes nën auditim si dhe ngarkesës e volumit të materialeve.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën PESTLE duke marrë në konsideratë risqet e gjashtë fushave të ndryshme në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht në nivelin politik, ekonomik, social, teknologjik, ligjor e mjedisor. Analiza PESTLE është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar.¹⁷ Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Kjo analizë rritet ka karakter paraprak dhe në vazhdimësi të auditimit, nëse do të jetë e nevojshme, do të kryhet një rivlerësim dhe/ose përditësim i risqeve të identifikuara. Kjo analizë krahas risqeve që lidhen me politikat është fokusuar edhe në risqet ekonomike, sociale e mjedisore duke qenë se tërmeti ka patur pasojë drejtpërdrejtë në të tre këto fusha.

¹⁷www.free-management-ebooks.com. 2013 ISBN 978-1-62620-998-5

Tabela. 6: Analiza e Riskut¹⁸

P Political	E Economic	S Social	T Technologic al	L Legal	E Environment
<p>*Zgjedhjet e reja parlamentare dhe ndryshimet e mundshme në qeverinë e re.</p> <p>*Ndikimi i Pandemisë në mbledhjen e fondeve për financim të politikave rindërtuese.</p> <p>*Ndryshimet e vazhdueshme të Kryetarit të Bashkisë Durrës.</p> <p>*Mungesa e Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive.</p>	<p>*Faturë financiare e lartë (rreth 1 miliardë Euro).</p> <p>*Zhvendosja e donacioneve në drejtim të përballimit të COVID-19.</p> <p>*Shtim i nivelit të korrupsionit në situata emergjente.¹⁹</p> <p>Mundësia e rritjes së kostove të produkteve (pajisje ndërtimi, shërbime etj) për shkak të emergjencës së krijuar nga fatkeqësia.</p>	<p>*Impakt social shumë i madh duke qenë se u prekën direkt dhe indirekt rreth 200,000 njerëz, 51 humbje jete dhe rreth 900 të plagosur.</p> <p>*Mungesë informacioni për mënyrën e të kërkuarit dhe shpërndarjes së ndihmave.²⁰</p> <p>*Shpërndarje e pabarabartë e ndihmave e cila mund të ndodhë kur individë ose grupe të vecanta favorizohen në marrjen e ndihmave, duke bërë që ndihmat mos të shkojnë aty ku ka patur dëme më të mëdha.²¹</p>	<p>*Mungesa potenciale e përdorimit të teknologjive të eficiencës së energjisë në procesin e rindërtimit.²²</p> <p>*Dëme dhe humbje monetare të konsiderueshme sa i përket infrastrukturës dhe aseteve fizike.</p>	<p>*Mungesa e një plan veprimi të qartë dedikuar për tërmetit të Nëntorit 2019 shoqëruar me tregues të matshëm.</p> <p>*Krijimi i një strukture te re për Rindërtimin, të pakoordinuar me strukturën e emergjencave civile.</p> <p>*Mundësia e mbivendosjes së detyrave dhe përgjegjësive që rrjedhin nga ligji Nr.45/2019 për mbrojtjen civile, dhe Akti Normativ Nr.9 datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.</p> <p>*Mungesa e Rregullores së Brendshme të miratuar të AKMC.</p> <p>*Ndryshime të shpeshta të formatit të vlerësimit të dëmeve të tërmetit e cila mund të ngadalësojë procesin e vlerësimit të dëmeve.</p>	<p>*Durrësi përbëhet nga depozitime të shkrifëta kuaternare të dobëta si rëra, surëra, suargjila etj., dhe paraqitet një zonë me kushte të favorshme për zhvillimin e dukurisë së lëngëzimit të rërave.</p> <p>Rëndësia e zgjedhjes së trojeve të fortë e të thatë për bazamentet e godinave, duke shmangur trojet e butë e të ngopur me ujë, është mjaft e madhe për reduktimin e dëmeve potenciale nga tërmetet.²³</p> <p>*Shumë katastrofa shkaktojnë dëme në mjedis dhe ekosisteme. Procesi i rehabilitimit dhe rindërtimit mund të shkaktojë dëme të mëtejshme dhe kjo mund të shkaktojë katastrofat e ardhshme.²⁴</p>

Burimi: Grupi i auditimit

¹⁹ISSAI 5520: 6.2.

²⁰ISSAI 5520, fq 17, gërma òCö.

²¹ISSAI 5520, fq 18, gërma òMö.

²²PDNA, Volume A, fq 12.


²³ Guri. S., Drithërimat e tokës dhe të njeriut, Çrëduhet dhe çamund të dimë për tërmetet, 2020, fq 156, 159.

²⁴ISSAI 5520, fq 19, gërma òMö.

3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë "Efektiviteti i programeve për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore 2019" ka si objektiv kryesor vlerësimin e politikave dhe efektivitetit të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin në tërësi të situatës së krijuar nga tërmeti i 2019 duke u fokusuar kryesisht në ÷përgjigjenë e subjekteve publike ndaj të dëmtuarëve si dhe në procesin e rindërtimit. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi nëse burimet publike janë menaxhuar me përgjegjësi dhe nëse janë arritur rezultatet e dëshiruara. Me anë të këtij objektivi kemi mundur të konkludojmë se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi lidhur me menaxhimin e tërmetit të nëntorit të 2019.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka patur si fushë veprimi analizimin dhe dhënien e një opinioni mbiefektivitetin e procesit të rindërtimit i cili përbëhet nga pesë programe rindërtimi.²⁵ Auditimi për vetë kompleksitetin e tij ka patur një qasje në nivel makro duke prekur elementët më të rëndësishëm dhe duke filluar që me parapërgatitjen e institucioneve përgjegjëse lidhur me katastrofa natyrore siç është edhe tërmeti, përgjigjen e institucioneve përgjegjëse në momentin pas rënies së tërmetit dhe më tej me planifikimin për përballimin e pasojave dhe në fund me procesin e rindërtimit së bashku me programet e rindërtimit dhe nënprogramet përkatëse të tyre. Në këtë auditim nuk jemi fokusuar specifikisht në procedura të veçanta prokurimi për objekte të veçanta duke qenë se fokusi ynë do jetë kryesisht drejt politikave për menaxhimin e katastrofave natyrore, shpërndarjes së fondeve si dhe kapaciteteve për përballimin e situatave të tilla. Periudha e auditimit ka qenë nëntor 2019-prill 2021. Gjatë këtij auditimi janë zhvilluar vizita në terren në disa prej zonave më të prekura nga tërmeti i nëntorit konkretisht në Bashkinë Durrës. Siç u përmend edhe në kapitujt e mësipërm subjektet kryesore ku është fokusuar ky auditim janë shtatë dhe konkretisht Ministria e Shtetit për Rindërtim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia e Tiranës dhe Durrësit, Agjencia Kombëtare për Planifikimin e territorit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes civile si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Ky numër kaq i madh subjektësh është përzgjedhur për të patur dhe për të dhënë një panoramë sa më të plotë të të gjithë ciklit dhe të gjithë aktorëve përgjegjës për menaxhimin e situatës së krijuar nga tërmeti i 2019.

3.5 Qasja/metodologjia e auditimit

Grupi i auditimit vendosi mbi qasjen e përshtatshme për zhvillimin e këtij auditimi bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë fazës studimore, komunikimet me institucionet e përfshira në auditim. Tri do të jenë qasjet audituese që janë përdorur:

1. Duke qenë se në këtë auditim nevojitet informacion i përgjithshëm në lidhje me procedurat e ndjekura për përfitimin e ndihmave apo fondeve për të parë nëse janë arritur përfitimet e pritshme nga këto fonde, qasja sasiore është një mënyrë mjaft e vlefshme për të arritur në konkluzione me besueshmëri të lartë. Kjo qasje përfshin përpilimin e anketave dhe pyetësorëve, shqyrtimin e rezultateve dhe hartimin e statistikave.
2. Qasja cilësore duke qenë më tepër qasje problemore dhe ku problemi nuk mund të kuantifikohet, është përdorur për atë pjesë të materialeve ku treguesit janë të pamatshëm.
3. Përveç dy qasjeve të mësipërme, për shkak të kompleksitetit të auditimit, është përdorur dhe qasja pragmatike. Kombinimi i qasjes sasiore me atë cilësore përdoret për të ndihmuar në dhënien e zgjidhjes ndaj një problemi të caktuar.

Metodat e përdorura në metodologjinë e përzgjedhur janë si vijon:

- Rishikimi, analiza dhe vlerësimi i të dhënave të mbledhura gjatë fazës studimore të auditimit;
- Intervista dhe pyetje të hapura me stafin e subjekteve nën auditim si dhe me palët e interesit;
- Mbledhje të dhënash nga burime sekondare dhe analizë e tyre;
- Marrje të dhënash dhe studim i tyre nga botime dhe publikime të ndryshme;
- Analizë sasiore dhe cilësore të të dhënave të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve;
- Konsulta me ekspertë të fushës, jashtë subjekteve të auditimit;
- Studim arkivor;
- Vëzhgim në terren i gjendjes dhe situatës për të parë nga afër problematikat;
- Konsultim i literaturës, ISSAI 5510 dhe ISSAI 5520.

²⁵ Akt normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 18.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

A KA QENË EFEKTIV MENAXHIMI I TËRMETIT TË 26 NËNTORIT 2019?


Mesazhi i auditimit

Edhe pse institucionet përgjegjëse në këto vite kanë qenë aktive në menaxhimin e situatës së post tërmetit të 2019, performanca e tyre nuk ka qenë plotësisht efektive. Krahas mungesës së hartimit dhe miratimit nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të politikave me qëllim parandalimin, zbutjen dhe gatishmërinë e risqeve të katastrofave natyrore të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen civile, një ndër dokumentet kryesore i cili nuk është miratuar është Programi i Përgjithshëm i Rindërtimit. Portali unik qeveritar i cili duhej të garantonte transparencën e plotë në funksion të përdorimit të fondeve të procesit të rindërtimit nuk është konceptuar dhe nuk përmbush të gjitha detyrimet e përcaktuara në Aktin Normativ për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Fondet e alokuara në Bashkitë Tiranë dhe Durrës nuk janë bërë në përputhje të plotë me PDNA (*Post Disaster Needs Assessment* ó Vlerësimi i Nevojave Post Kastrofe) i cili është i vetmi dokument orientues që ka përllogaritur dëmet sipas sektorëve të veçantë si për shembull shëndetësi, arsim, infrastrukturë, banesa etj. Nga ana tjetër bashkëpunimi dhe koordinimi midis institucioneve nuk ka rezultuar plotësisht efektiv sa i përket shkëmbimeve të informacioneve, kontributeve në natyrë, trajnimeve për raste të fatkeqësive natyrore etj. Bashkitë Tiranë dhe Durrës nuk kanë dërguar të dhëna në AKMC lidhur me akt vlerësimet e bëra në subjekte të dëmtura nga tërmeti i 2019. Edhe pse me vonesë, miratimi i Programit të Përgjithshëm të Rindërtimit me qëllim planifikimin dhe përcaktimin e afateve kohore për përballimin e pasojave të tërmetit të 2019 do të ndihmonte të gjithë procesin e rindërtimit në tërësi.

4.1 A kanë qenë efektive politikat për menaxhimin e tërmetit të 2019?

Grupi i auditimit i ka trajtuar politikat për menaxhimin e tërmetit të nëntorit të 2019 në dy faza (para dhe pas tërmetit të 2019) për të cilat ka ndërtuar dy nënpyetje auditimi, përkatësisht nënpyetjen 4.1.1 dhe 4.1.2. Nënpyetja 4.1.1 òA ekzistojnë politika të duhura për parandalimin, zbutjen, dhe gatishmërinë ndaj katastrofave natyrore si rasti i tërmetit 2019, i atribuohet dhe kërkon t'ia japë përgjigje fazës òpara katastrofë ose para tërmetit duke trajtuar aspekte dhe çështje që kanë të bëjnë me parandalimin, zbutjen dhe gatishmërinë në raste katastrofash natyrore. Në këtë pyetje, në vijim janë trajtuar politika, dokumente, programe që duhet të jenë hartuar dhe miratuar për fazën para katastrofës duke u mbështetur në kuadrin ligjor vendas dhe në veçanti në Ligjin nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civile si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit ISSAI 5510 òAuditimi mbi reduktimin e riskut të katastrofave. Ndërsa në pyetjen 4.1.2 "A kanë hartuar institucionet përgjegjëse politika të përshtatshme për përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019" i është kushtuar vëmëndje politikave për përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019, pra fazës òpas katastrofë. Si kritere në këtë pyetje përveç kuadrit ligjor e rregullator (shtjelluar gjerësisht në pyetjen përkatëse më poshtë) është përdorur edhe ISSAI 5520 òAuditimi i ndihmave lidhur me katastrofat i cili parashtron aspekte që duhen trajtuar në një auditim pasi katastrofa ka ndodhur.

Fig. 3 Cikli i menaxhimit të katastrofave



Burimi: ISSAI 5510, fq. 6

4.1.1 A ekzistojnë politika të duhura për parandalimin, zbutjen, dhe gatishmërinë ndaj katastrofave natyrore si rasti i tërmetit 2019?

Reduktimi i rrezikut nga katastrofat përfshin masa që përgatisin komunitetet për fatkeqësi të mundshme dhe përmirësojnë reagimin e palëve të ndryshme të përfshira në ngjarje të tilla. Aktivitetet për reduktimin ndaj rrezikut të katastrofave synojnë të zvogëlojnë ndikimin e tyre duke siguruar që palët e interesuara të mos kapen të papërgatitur nga katastrofa dhe mbi të gjitha ndihma të ofrohet në mënyrë të koordinuar.²⁶Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 5510 ashtu si edhe Ligji nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civileò e përcaktojnë òParandalimin” ndaj katastrofave si grupimi i të gjitha aktiviteteve dhe masave me qëllim shmangien e plotë të risqeve të fatkeqësive ekzistuese dhe atyre të reja. òZbutja”²⁷ është zvogëlimi ose kufizimi i ndikimeve negative të rreziqeve dhe katastrofave. "Masat zbutëse përfshijnë teknikat inxhinierike dhe rezistente ndaj rreziqeve ndërtimi si dhe përmirësimi i politikave mjedisore dhe ndërgjegjësimi i publikut.òGatishmëriaò²⁸ është tërësia e kapaciteteve të zhvilluara nga sistemi i mbrojtjes civile dhe komuniteti, për të parashikuar, për t’u përgjigjur dhe për t’u rimëkëmbur në mënyrë efektive nga impaktet e fatkeqësive të mundshme, të afërta apo reale.

²⁶The European Commission on EU Strategy for Disaster Risk Reduction, 15/4-2008 and Austrian Development Cooperation, “International humanitarian aid policy document”, Vienna, March 2009, p.9.

²⁷ISSAI 5510, fq 9.

²⁸Ligji nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civileò, fq 3.

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë.

Një tjetër dokument mjaft i rëndësishëm është edhe Plani Kombëtar i Emergjencave Civile. Plani Kombëtar i Emergjencave Civile (PKEC) më i fundit është ai i hartuar dhe miratuar me anë të VKMsë nr. 835, datë 03.12.2004. Ky plan është ideuar si një burim praktik i përdorshëm për të gjitha fazat e ciklit të emergjencave, duke filluar nga parapërgatitja, përgjigjja dhe duke vazhduar më tej në fazën e rikthimit në gjendjen normale dhe lehtësimin e pasojave. Në brendësi të këtij plani të hartuar 17 vjet më parë, theksohet si ai duhet të rishikohet e të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar bashkëpunimin e përhershëm dhe ndryshimet në nevoja dhe burime të Shqipërisë. PKEC-ja është hartuar në mbështetje të Ligjit nr. 8756, datë 26 mars 2001, òPër emergjencat civile, ligj që është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr 45/2019 òPër mbrojtjen civile.

Nëpërmjet PKEC-së i miratuar me VKM nr. 835 datë 03.12.2004 synohet:

- Të parandalohet, të lehtësohet dhe të riaftësohet nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.
- Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në njësitatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjence civile.
- Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme të shtetit me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Ligji nr 45/2019 òPër mbrojtjen civile është miratuar në datën 18.7.2019. Në nenin 75 të po këtij ligji është theksuar që ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ligji nr 45/2019 òPër mbrojtjen civile është publikuar në Fletoren Zyrtare²⁹ në datë 01.08.2019 që do të thotë se ai hyn në fuqi më datë 16.08.2019.

Gjetje

1. Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë nuk është hartuar dhe miratuar duke mos përmbushur detyrimet e Ligjit nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civile, neni 10 pika 1, neni 23 pika 6 gërma òcò dhe neni 72 pika 1 gërma òaò. Në nenin 72 pika 1 gërma òaò specifikohet se Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut duhet të ishte përgatitur deri në 2 vjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr 45/2019 òPër mbrojtjen civile. Mungesa e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë sjell automatikisht edhe mungesën e hartimit të Strategjive Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë nga ana e Njësive të Vetëqeverisjeve Vendore siç është edhe rasti i Bashkive Tiranë dhe Durrës.
2. Vlerësimi i riskut në nivel qendror nuk është hartuar dhe nuk është miratuar me VKM në mos përputhje me Ligjin nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civile, neni 9 pika 3, neni 23 pika 6 gërma òcò dhe neni 72 pika 1 gërma òaò. Në nenin 72 pika 1 gërma òaò specifikohet se Vlerësimi i riskut në nivel qendror duhet të ishte përgatitur deri në 2 vjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr 45/2019 òPër mbrojtjen civile.
3. Vlerësimi i riskut identifikon llojin, karakteristikën dhe prejardhjen e risqeve nga fatkeqësitë, nivelin e ekspozimit dhe të cënueshmërisë, faktorët që e shkaktojnë apo që e rrisin nivelin e mundësisë së rrezikut, si dhe pasojat e mundshme për jetën e njerëzve në nivel vendor.

²⁹Linku i publikimit në Fletoren Zyrtare të Ligjit nr 45/209 òPër mbrojtjen civile
<https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/113/837b2b34-2833-4add-8635-994462b57cc5>

- Vlerësimi i riskut në nivel vendor nuk është hartuar dhe miratuar me VKB nga Bashkitë Durrës dhe Tiranë në referencë të Ligjit nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civileò, neni 9 pika 5.
4. Plani Kombëtar i Emergjencave Civile i miratuar me VKM nr. 835 datë 03.12.2004 është bazuar në Ligjin nr. 8756, datë 26 mars 2001, òPër emergjencat civileò, ligj që është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr 45/2019 òPër mbrojtjen civileò. Krahas bazës ligjore, duke qenë se kanë kaluar rreth 17 vjet, ky plan nuk është i përshtatshëm dhe efektiv në kushtet e sotme duke qenë se gjatë kësaj kohe institucionet dhe organizmat publike kanë pësuar ndryshime në organizimi si dhe në ndarje përgjegjësie sa i përket strukturave, duke e bërë të pamundur zbatimin e këtij plani.
 5. AKMC-ja, nuk ka krijuar fondin e solidaritetit për mbrojtjen civile nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, referuar Ligjit nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civileò neni 66 pika 1. Ky fond përdoret për përballimin e situatave emergjente dhe mund t'ua transferohet njërive të vetëqeverisjes vendore, me kërkesën e tyre.
 6. Referuar Ligjit nr 45/2019 òPër mbrojtjen civileò neni 13 pika 3 dhe 4 òVërtetimi mbi riskun jepet nga Këshilli Kombëtar i Territorit, në rastet kur ai është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen, lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo që kanë lidhje me investime strategjike për interesat e vendit ose nga Kryetari i Bashkisë, në rastet kur ai është përgjegjës për vendim marrjen, lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë. Vërtetimi mbi riskun certifikon ndërtimin bazuar mbi analizën e rrezikut, cënueshmërinë dhe ekspozimin e tij. Kryetarët e Bashkive Tiranë dhe Durrës për periudhën nën auditim nuk kanë aplikuar vërtetime mbi riskun lidhur me lejet e zhvillimit dhe leje ndërtimit e dhëna në territorin administrativ të këtyre bashkive në mos përputhje me Ligjin nr 45/2019 òPër mbrojtjen civileò neni 13 pika 4.

Konkluzione

1. Mungesa e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF) sjell efekte negative në politikat dhe aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore përgjegjëse në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë. Megjithatë, gjatë kohës së kryerjes së këtij auditimi, ka filluar punën për përgatitjen dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Me anë të Urdhërit nr. 57 të Kryeministrit datë 29.06.2021 òPër ngritjen e grupit ndërinstitucional dhe grupit teknik ndërinstitucional të punës për përgatitjen e Projektit të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është ngritur grupi ndërinstitucional i punës i përbërë nga një sërë Zëvendës Ministrash si dhe Agjenci e Institucione të ndryshme publike. Afati i përcaktuar në këtë Urdhër për dorëzimin e SKZRF në Ministrinë e Mbrojtjes nga ana e grupit të punës është data 15.11.2021.
2. Mungesa e Vlerësimit të Riskut si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor sa i përket Bashkive Tiranë dhe Durrës sjell mangësi në përcaktimin e natyrës dhe shkallës së riskut. Ai është shumë i rëndësishëm sa i përket analizës së rreziqeve të mundshme dhe vlerësimit të kushteve ekzistuese të ekspozimit dhe cënueshmërisë, që së bashku mund të dëmtojnë njerëzit, pronën, shërbimet, jetesën dhe mjedisin e ekspozuar nga i cili ato varen. Realizimi i Vlerësimit të Riskut do të ndihmojë qeverisjen qendrore dhe vendore për marrjen e masave dhe për përgatitjen në raste të fatkeqësive natyrore dhe jo vetëm. Edhe për Vlerësimin e Riskut në nivel qendror gjatë kohës së realizimit të këtij auditimi ka filluar puna për hartimin e tij. Me anë të Urdhërit nr. 59 të Kryeministrit datë 29.06.2021 òPër ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës për kryerjen e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror është ngritur grupi ndërinstitucional i punës i përbërë nga një sërë Zëvendës Ministrash si dhe Agjenci e Institucione të ndryshme publike. Afati i

- përcaktuar në këtë Urdhër për hartimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror është 30 nëntor 2021.
3. Plani Kombëtar i Emergjencave Civile i miratuar me VKM nr. 835, datë 03.12.2004 është thujtë i pamundur të vihet në zbatim duke qenë se strukturat dhe organizmat kanë ndryshuar me të gjitha ndryshimet e kuadrit ligjor që kanë pësuar emergjencat civile. Praktikën e miratuar edhe dokumentat e ngjashëm në fusha apo sektorë të tjerë dëshmojnë se plane të tilla nuk mund të mbijetojnë një periudhë kaq të gjatë prej gati 20 vjeçare, ndaj është e rëndësishme që ato të përditësohen për të qenë në sinkron me situatën aktuale. Me anë të Urdhërit nr. 58 të Kryeministrit datë 29.06.2021 për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional dhe grupit teknik ndërinstitucional të punës për përgatitjen e Projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile është ngritur grupi ndërinstitucional i punës për përgatitjen e PKECi përbërë nga një sërë Zëvendës Ministrash si dhe Agjenci e Institucione të ndryshme publike. Afati i përcaktuar në këtë Urdhër për hartimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror është 15 nëntor 2021.
 4. Fondi i solidaritetit duhet përdorur për përballimin e situatave emergjente sic është edhe rasti i tërmetit të 2019, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik. Mungesa e krijimit të këtij fondi ka sjellë edhe kufizime në përballimin e situatës problematike të shkaktuar nga tërmetit i nëntorit 2019.
 5. Para pajisjes nga organet kompetente me leje zhvillimore, të gjitha subjektet duhet të pajisen me vërtetim mbi riskun. Vërtetimi mbi riskun certifikon ndërtimin bazuar mbi analizën e rrezikut, cënueshmërinë dhe ekspozimin e tij. Në rastet kur Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për vendimmarrjen lidhur me lejen zhvillimore dhe lejen e ndërtimit, vërtetimi mbi riskun duhet të jepet nga ky i fundit. Mungesa e dhënies së vërtetimit të riskut për lejet zhvillimore dhe lejet e ndërtimit të dhëna në territorin e Bashkive Tiranë dhe Durrës sjell pasiguri sa i përket ekspozimeve të ndërtimeve ndaj rreziqeve të ndryshme të fatkeqësive natyrore.

Rekomandime

1.1 AKMC në cilësinë e grupit teknik ndërinstitucional të punës të marrë masa dhe të bashkëpunojë me grupin ndërinstitucional të punës me qëllim hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë deri në miratimin e saj me VKM.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.2 Bashkitë Tiranë dhe Durrës, pas miratimit me VKM të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë të marrin masa për hartimin dhe miratimin me VKB të Strategjive Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

6 muaj pas miratimit me VKM të SKZRF

2.1 AKMC në cilësinë e organizatorit të mbledhjeve të grupit ndërinstitucional të punës lidhur me Vlerësimin e Riskut në nivel qendror si dhe në cilësinë e raportuesit periodik të Kryeministrit, të marrë masa dhe të bashkëpunojë me të gjithë anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës me qëllim hartimin e Vlerësimit të Riskut në nivel qendror.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.1 Bashkitë Tiranë dhe Durrës të marrin masa për të hartuar dhe miratuar me VKB vlerësimin e riskut në nivel vendorë në përputhje me Ligjin nr. 45/2019 për mbrojtjen civile, neni 9 pika 5.

Qershor 2022

4.1 AKMC në cilësinë e grupit teknik ndërinstitucional të punës të marrë masa dhe të bashkëpunojë me grupin ndërinstitucional të punës me qëllim hartimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile

në përputhje me Ligjin nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civileò, neni 23 pika 6 dhe Urdhërin nr. 58 të Kryeministrit datë 29.06.2021 òPër ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstytucional dhe grupit teknik ndërinstytucional të punës për përgatitjen e Projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civileò.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4.2 Bashkitë Tiranë dhe Durrës, pas miratimit me VKM të Planit Kombëtar të Emergjencave Civile të marrin masa për hartimin dhe miratimin me VKB të Planit Vendor të Emergjencave Civilenë përputhje me Ligjin nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civileò, neni 14 pika 6.

6 muaj pas miratimit me VKM të PKEC

7

5.1 AKMC nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, të marrë masa për të krijuar një fond solidariteti, për mbrojtjen civile në përputhje me Ligjin nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civileò, neni 66.

Deri në prill 2022

6.1 Kryetarët e Bashkive Tiranë dhe Durrës në rastet kur ata janë përgjegjës për vendimmarrjen, të marrin masa për të dhenë vërtetime mbi riskun lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkive përkatëse në përputhje me Ligjin nr 45/2019 òPër mbrojtjen civileò neni 13 pika 4.

Në vazhdimësi

4.1.2 A kanë hartuar institucionet përgjegjëse politika të përshtatshme për përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019?

òGjendja e fatkeqësisë natyroreò,³⁰ sht gjendja e vendosur nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile, në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose të fatkeqësive të tjera. Gjendja e fatkeqësisë natyrore është shpallur me VKM nr. 750 datë 27.11.2019 òPër shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës dhe Tiranëò. Me anë të kësaj VKM-je, krijohet gjithashtu Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile (KNC) si organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve ë institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe burimeve financiare e materialepër përballimin e fatkeqësisë natyrore. KNEC kryesohet nga Kryeministri.

Një ndër dokumentet kryesore të hartuara nga Qeveria Shqiptare pas ndodhjes së tërmetit të nëntorit 2019 është Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò. Ky akt rregullon funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse. Ky akt ka për qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të fatkeqësive të tjera që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile dhe të autoriteteve të tjera shtetërore dhe për të cilat shpallet gjendja e fatkeqësisë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile. Dallimi midis Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò me dokumente të tjerë politikë si Strategji apo Plane Kombëtare për Emergjencat Civile është se këto të fundit

³⁰Ligji nr. 45/2019 òPër mbrojtjen civileò, neni 3 pika 13

prekin edhe fazat para se të ndodhë katastrofa, pra parandalimi, zbutja dhe gatishmëria, ndërsa Akti Normativ nr. 9 fokusohet më së shumti në fazat e rehabilitimit dhe rindërtimit, pra pasi ka ndodhur katastrofa. Në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 13 gërma òbò pika òiiò, thuhet se Këshilli i Ministrave miraton Programin e Përgjithshëm të Rindërtimit. Në nenin 14 pika 4 të po këtij Akti theksohet se Komisioni Shtetëror i Rindërtimit harton dhe i propozon Këshillit të Ministrave programin e përgjithshëm të rindërtimit.

Programi i përgjithshëm i rindërtimit përmban të paktën të dhëna për:

- a) personat që kanë humbur jetën nga fatkeqësia;
- b) familjet e mbetura të pastreha ose të dëmtuara, të renditura sipas kriterëve të përparësisë që parashikohen në këtë ligj;
- c) ndërtesat e dëmtuara dhe të rrezikuara, të ndara në publike dhe private;
- ç) kushtet dhe kriteret e përfitimit në përputhje me programet e procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti;
- d) objektet e infrastrukturës publike dhe kritike, si dhe veprat e trashëgimisë kulturore, zonat e mbrojtura dhe burimet natyrore të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore;
- dh) vlerën e dëmeve të shkaktuara, për aq sa është e mundur;
- e) masat që rekomandohen të merren në kuadër të programeve të procesit të rindërtimit dhe buxhetet e përafërta, nëse ka.³¹

Ministri i Shtetit për Rindërtimin

Me anë të VKM-së nr. 11, datë 10.1.2020 òPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin u vendos miratimi i fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin. Ministri i Shtetit për Rindërtimin është përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit tëmasave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019. Ministri i Shtetit për Rindërtimin ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë eminstrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për:

- a) hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara;
- b) planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit;
- c) evidentimin e burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore, dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit;
- ç) drejtimin operacional të strukturave dhe të njësisve të veçanta, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, në terren, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit;
- d) ndjekjen e zbatimit të përgjegjësisë dhe të detyrave të ngarkuara për ministritë dhe institucionet e tjera, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose që kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit;
- dh) ndjekjen e zbatimit të përgjegjësisë dhe të detyrave të ngarkuara për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe të strukturave në varësi të tyre, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit;
- e) ndjekjen e zbatimit të përgjegjësisë dhe të detyrave të ngarkuara për strukturat e posaçme, të ngritura me ligj apo vendim, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti.³²

³¹ Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 14 pika 5.

³² VKM nr. 11, datë 10.1.2020 òPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit

Me anë të VKM nr. 878 datë 24.12.2019 òPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò, Këshilli i Ministrave vendosi ngritjen dhe organizimin e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit si një organ ndërmintor për bashkërendimin e punës së ministrive, institucioneve të tjera përgjegjëse si dhe organeve të vetëqeverisjes vendore. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit kryesohet nga ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrine Brendshëm;
- Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Ministrin e Kulturës;
- Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrin e Turizimit dhe Mjedisit;
- Kryetarin e Bashkisë Tiranë, me kërkesë të tij.

Në Kreun 3 të VKM nr. 878 datë 24.12.2019 òPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò, është e përcaktuar qartë Veprimtaria e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit i cili ushtron këto kompetenca:

- Harton dhe miraton programin e përgjithshëm të rindërtimit;
- Bashkërendon veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, pëfshirë donatorët, në përputhje me programin e përgjithshëm të rindërtimit si dhe me procesin e rindërtimit;
- Në konsultim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonave të reja për ndërtim;
- Siguron informimin e publikut dhe transparencën mbi procesin e rindërtimit;
- Propozon, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, pranë Këshillit të Ministrave përdorimin e fondit të rindërtimit nga njësitë zbatuese dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përcaktimin e njësive zbatuese për projektet në kuadër të procesit të rindërtimit;
- Monitoron periodikisht zbatimin e programit dhe të detyrave të caktuara njësive zbatuese dhe përgatit raporte për Këshillin e Ministrave;
- Përcjell dhe propozon, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, pranë Këshillit të Ministrave, projektvendimet që kanë të bëjnë me çështjet e adresuara nga njësitë zbatuese.

Sekretariati Teknik i Komisionit Shtetëror të Rindërtimit

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen funksionin e sekretariatit teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit. AKMC përveç detyrave të përcaktuara Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përbërjen e pasojave të fatkeqësisë natyroreò ka këto përgjegjësi:

- Administron të gjithë dokumentacionin që është objekt shqyrtimi dhe vendimmarrjeje në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit;
- Merr masa për të njoftuar dhe organizuar mbledhje të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit;
- Ka përgjegjësi për të organizuar, drejtuar dhe bashkërenduar procesin me autoritete të tjera përgjegjëse, në nivel qendror dhe ose vendor, me qëllim përgatitjen për shqyrtim dhe miratim të akteve në kompetencë të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit;
- Përgatit projektaktet që do të miratohen nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, pas shqyrtimit të propozimeve.

Referuar figurës 3, Ciklit të Menaxhimit të Katastrofave, në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 5520 fq 10, janë përcaktuar afatet kohore të fazave të ÷post katastrofës. Faza e përgjigjes dhe lehtësimit të dëmeve e cila ka të bëjë me dhënien e ndihmës së pare, shpëtimit të jetëve, furnizimin me ujë e ushqim si dhe dhënien e ndihmës mjekësore cilësohet si një fazë urgjente e cila shkon nga disa ditë deri në 3 muaj pas katastrofës. Faza e rehabilitimit në të cilën trajtohen elementë që kanë të bëjnë me përkujdesjen e të dëmtuarëve, lehtësimit ekonomik të tyre, garantimin kujdesishtë shëndetësor të vazhdueshëm, garantimin e shërbimeve publike bazike, vendosjen e të dëmtuarëve në streha të përkohshme etj., është njëfazë e cila shkon nga disa muaj deri në 1 vit. Faza e rindërtimit e cila ka të bëjë me ndërtimin e banesave të përhershme, zhvillimin dhe rimëkëmbjen e sektorëve ekonomik, rindërtimit e objekteve social, kulturore shëndetësore etj., shkon deri në 5 vjet.

Transparenca

Akti Normativ Nr. 9, datë 16/12/2019 ÷Për përballimin e pasojave të fatkrqësisë natyrore, Neni 10, Parimi i informimit dhe transparencës *citon*: Autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Gjithashtu neni 38 pika 2 shkronja b, e Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019, përcakton përbajtjen e portalit unik qeveritar i cili duhet të përmbajë dhe jo vetëm:

- *të dhëna mbi fondin e rindërtimit*
- *burimin e krijimit të tij*
- *kontributet në para dhe kontributet në natyrë*
- *mënyrën e shpenzimit të këtij fondi*

Nga shqyrtimi i portalit unik qeveritar <https://rindertimi.gov.al/>. konstatohen mungesa si më poshtë: Mungojnë të dhënat mbi fondin e rindërtimit për periudhën 2020, 2021 me ndryshimet përkatëse; Mungojnë të dhënat mbi burimin e krijimit të fondit të rindërtimit; Mungojnë të dhëna mbi kontributet në para dhe kontributet në natyrë; Mungojnë të dhëna që tregojnë mënyrën e shpenzimit të fondit të rindërtimit në mënyrë akumulative dhe të qartë për publikun.

Në lidhje me sa më sipër nga ana e grupit të auditimit u mbajt Akt Konstatim protokolluar në MSHR me nr. 3501/1 prot. datë 08.09.2021. Një tjetër çështje që u evidentua lidhur me portalin unik qeveritar ose portalin e transparencës siç njihet ndryshe ishte edhe se Minisri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka përcaktuar nëpërmjet një akti nënligjor (Urdhër apo Udhëzim) personin përgjegjës për administrimin e portalit unik qeveritar.

Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Bashkisë Tiranë <https://www.tirana.al>, dhe Bashkisë Durrës <https://www.durres.gov.al>, si edhe nga përgjigjet e pyetësorëve të fazës së terrenit analizuar nga këto subjekte rezulton mungesë totale informacioni që lidhet me procesin e rindërtimit. Sipas subjektit ÷*Faqja zyrtare e Bashkisë Tiranë, nuk ka të dhëna për arsye të mbingarkesës së stafit gjatë periudhës së tërmetit, dhe pakësimit të stafit gjatë periudhës së pandemisë*”, çka nuk justifikon mungesën e transparencës me publikun.

Gjetje

7. Programi i përgjithshëm i rindërtimit nuk është hartuar nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit në reference të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ÷Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 13 gërma ÷bë pika ÷iiö, dhe VKM nr. 878 datë 24.12.2019 ÷Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Kreu 3, pika 1, gërma ÷aö.
8. Krahas mungesës së këtij Programi nuk ekziston asnjë dokument tjetër politik zyrtar i cili të përcaktojë qartë afate kohore se kur do të përfundojë i gjithë procesi i rindërtimit. Këto afate,

referuar Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 5520, tabela 1 fq. 10, janë shumë të rëndësishme për planifikimin dhe përballimin të situatës post katastrofë.

9. Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, dhe VKM nr. 878 datë 24.12.2019 òPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò, kanë mos përputhje sa i përket miratimit të programit të përgjithshëm të rindërtimit. Në nenin 13 gërma òbò pika òiiò, të Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, theksohet se është Këshilli i Ministrave që miraton Programin e Përgjithshëm të Rindërtimitò, ndërsa referuar Kreut 3 pika 1, gërma òaò të VKM nr. 878 datë 24.12.2019 òPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò, theksohet se është Komisioni Shtetëror i Rindërtimit ai që miraton programin e përgjithshëm të rindërtimit.
10. Edhe pse AKMC ka vënë në dispozicion të Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit disa specialistë, AKMC nuk ka dijeni për përbërjen e plotë të këtij Sekretariati dhe për rrjedhje nuk ka mbajtur rregjistër protokollit më vete për veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimitit në mos përputhje me VKM nr. 878 datë 24.12.2019 òPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò, Kreu 4 pika 8.
11. Planet e masave rikuperuese dhe parandaluese nuk janë hartuar nga ministrinë përgjegjëse të përcaktuara në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, neni 31 pika 1 dhe nuk janë miratuar nga Ministri i Shtetit për Rindërtimin edhe pse Ministri i Shtetit për Rindërtimin me anë të shkresës me nr. Prot 476/1 datë 11.02.2020 me objekt òMbi përmbushjen e detyrimeve ligjore në kuadër të procesit të Rindërtimit, u ka kërkuar ministrive përgjegjëse hartimin e këtyre planeve.
12. Referuar Aktit Normativ Nr. 9, datë 16/12/2019ò Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, Neni2 shkronja b, në portalin unik qeveritar të krijuar për garantimin e transparencës së procesit të rindërtimit qeveritar <https://rindertimi.gov.al/>. mungojnë;
 - të dhënat mbi fondin e rindërtimit për periudhën 2020, 2021 me ndryshimet përkatëse;
 - të dhënat mbi burimin e krijimit të fondit të rindërtimit;
 - të dhëna mbi kontributet në para dhe kontributet në natyrë;
 - të dhëna që tregojnë mënyrën e shpenzimit të fondit të rindërtimit në mënyrë akumulative dhe të qartë për publikun;
13. Referuar Aktit Normativ Nr. 9, datë 16/12/2019ò Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, Neni 10 , në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë <https://www.tirana.al>, dhe Bashkisë Durrës <https://www.durres.gov.al>, mungojnë të dhëna mbi të ardhura, donacione apo shpenzime që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

Konkluzione

6. Programi i përgjithshëm i rindërtimit është një ndër dokumentet kryesore që lidhet me planifikimin e aktiviteteve të përballimit të situatës së òpas katastrofësò. Mungesa e një programi të tillë ndikon drejtpërsëdrejti në menaxhimin efektiv dhe eficient të fazave të rehabilitimit dhe rindërtimit. Referuar përgjigjeve të subjekteve të auditimit, konkretisht Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, justifikimi i tyre për mungesën e programit lidhet me faktin e realizimit të PDNA (*Post Disaster Needs Assessment* ó Vlerësimi i Nevojave Post Katastrofë) i cili nga vetë përmbajtja e tij është një studim apo vlerësim i dëmeve të tërmetit të 2019 dhe jo një dokument zyrtar i miratuar me VKM siç përcaktohet për Programin e Përgjithshëm të Rindërtimit. Mungesa e një dokumenti zyrtar sa i përket planifikimit dhe përballimit të situatës post tërmet ndikon gjithashtu edhe tek të dëmtuarit dhe të prekurit nga tërmeti i 2019 duke qenë se shton pasigurinë e tyre lidhur me afatet e trajtimit apo marrjes së ndihmave.
7. Mos koordinimi ose mos përputhja e Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, dhe VKM-së nr. 878, datë 24.12.2019 òPër përbërjen,

organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit shton edhe më shumë paqartësinë e dokumenteve politike se kush duhet të bëjë çfarë. Dokumentet politikë duhet të jenë të qarta dhe koncize dhe nuk duhet të lënë kurrësesi vend për keqkuptime apo dhe më tej, mos përputhje.

8. AKMC në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit përveç se nuk ka patur dijeni për përbërjen e plotë të këtij Sekretariati, nuk ka përmbushur gjithashtu detyrimet që i burojnë nga VKM nr. 878, datë 24.12.2019 për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Kreu 4 pika 3 dhe 8.
9. Sa i përket planeve të masave rikuperuese dhe parandaluese edhe pse Ministri i Shtetit për Rindërtimit e ka përmbushur detyrimin e vet duke qenë se i është drejtuar zyrtarisht ministrive përgjegjëse, siç specifikohet edhe në gjetjen nr. 5, konkluzioni është që këto masa nuk janë hartuar dhe nuk janë miratuar.
10. Mos publikimi në lidhje me burimin e krijimit të fondit të rindërtimit dhe mënyrën e shpenzimit të tij, çënon besueshmërinë të publiku dhe donatorët. MSHR, pavarësisht deklaratave publike të Ministrisë të Shtetit për Rindërtimin që kanë të bëjnë me ecurinë e procesit të rindërtimit, këto deklarata nuk përmbushin kërkesat për publikimin e të dhënave që duhet të jenë pjesë e portalit të transparencës referuar Aktit Normativ Nr. 9, datë 16/12/2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 38 pika 2.
11. Transparenca e procesit të rindërtimit forcon besimin te qytetarët dhe ndikon në rritjen e llogaridhënies së përdorimit të fondeve të rindërtimit. Publikimi i procesit të rindërtimit në nivel vendor dhe konkretisht në dy prej bashkive më të prekura nga tërmeti i 2019 si ajo e Durrësit dhe e Tiranës do të rriste transparencën dhe do të evitonte paqartësinë e qytetarëve të prekur në këto dy bashki.

Rekomandime

7.1 Komisioni Shtetëror i Rindërtimit të marrë masa për të hartuar dhe miratuar Programin e Përgjithshëm të Rindërtimit në përputhje me Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 13 gërma öb pika öiiö dhe neni 14 pika 5.

Deri në prill 2022

8.1 Ministri i Shtetit për Rindërtimin në rolin e hartuesit të politikave dhe masave për eliminimin e pasojave të tërmetit 2019 të propozojë në Këshillin e Ministrave për vendosjen e afateve kohore sa i përket menaxhimit dhe përballimit të situatës öpost tërmetö.

Deri në prill 2022

9.1 Komisioni Shtetëror i Rindërtimit të marrë masa dhe të propozojë në Këshillin e Ministrave ndryshimet përkatëse lidhur me mos përputhjen midis nenit 13 gërma öb pika öiiö, të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe Kreut 3 pika 1, gërma öaö të VKM nr. 878 datë 24.12.2019 për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit me qëllim përcaktimin e qartë dhe të saktë se kush duhet ta miratojë Programin e Përgjithshëm të Rindërtimit.

Deri në prill 2022

10.1 AKMC në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit në përputhje me VKM nr. 878 datë 24.12.2019 për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Kreu 4 pika 8 të organizojë dhe të mbajë regjistër protokollin më vete për gjithë veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

Në vazhdimësi

11.1 Ministri i Shtetit për Rindërtimin të kërkojë dhe t'ua drejtohet ministrive përgjegjëse të përcaktuara në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 31 pika 1, hartimin e planeve të masave rikuperuese dhe parandaluese dhe më tej të miratojë këto masa.

Deri në prill 2022

12.1 Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16/12/2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, Neni 14 shkronja ç, KSHR të marrë masa për të garantuar procesin e transparencës dhe publikimin e të dhënave në portalin unik qeveritar. Përmbajtja e portalit unik të transparencës duhet të jetë në përputhje gjithashtu me Aktin Normativ Nr. 9, datë 16/12/2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, Neni 38 pika 2.

Deri në prill në vazhdim

13.1 Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës të marrin masa për publikimin e të dhënave që lidhen me procesin e rindërtimit, në faqet zyrtare të tyre në përputhje me Aktin Normativ Nr. 9, datë 16/12/2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, Neni 10.

Deri në prill 2022

4.2 A është siguruar një shpërndarje e drejtë e fondeve të rindërtimit me qëllim përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit të 2019?

Dëmet dhe humbjet nga fatkeqësia natyrore

PDNA është i vetmi dokument zyrtar i evidentimit dhe vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve që shkaktoi tërmeti i datës 26 nëntor 2019. Nëpërmjet PDNA është kryer vlerësimi i efekteve total në humbje dhe dëme, të shkaktuara nga tërmeti.³³ Vlera e përgjithshme e aseteve dhe infrastrukturës të shkatërruar ose dëmtuar në 11 bashkitë e prekura, sipas PDNA është vlerësuar të jetë 103.8 miliardë lekë, dhe vlera e humbjeve totale arrin 17.4 miliardë lekë, duke shkuar në një total prej 121.2 miliardë lekë në kombinimin e dëmeve dhe humbjeve së bashku. Kjo vlerë totale përfaqëson rreth 7.5% të prodhimit të brendshëm bruto të Shqipërisë në vitin 2019³⁴, çka tregon edhe madhësinë e efekteve të tërmetit për ekonominë e vendit. Për sa i përket humbjeve, sektorët ekonomikë më të goditur ishin strehimi dhe turizmi, por dëme të konsiderueshme u shkaktuan edhe në arsim, shëndetësi, infrastrukturë publike, prodhim dhe tregti. PDNA parashikon afate kohore të cilat lidhen me kostot e ndërhyrjeve të nevojshme për rindërtimin dhe rimëkëmbjen. Për periudhën afatshkurtër afati kohor parashikohet deri në fund të vitit 2020. Për periudhën afatmesme parashikohet 2 vitet në vijim 2021 dhe 2022, ndërsa për periudhën afatgjatë shtrihet në dy vitet pasuese 2023 dhe 2024. Rezultatet e PDNA tregojnë se nevojat totale të rimëkëmbjes janë 132.4 miliardë lekë. Nga kjo shumë:

- 67.1 miliardë lekë, adresojnë nevojat.
- afatshkurtra dhe përfaqësojnë 51% të vlerës totale.
- 61.5 miliardë lekë, adresojnë nevojat afatmesme dhe përfaqësojnë 46.5% të vlerës totale.
- 3.8 miliardë lekë, adresojnë nevojat afatgjata dhe përfaqësojnë 2.5% të vlerës totale.


Mekanizmi financiar

Për të financuar gjithë procesin e rimëkëmbjes dhe rindërtimit pas katastrofës, u ngrit një mekanizëm financiar, i cili përcakton aktorët, burimet potenciale të financimit, alokimin dhe ekzekutimin e fondeve, etj.

³³PDNA Dëme=shkatërrimi total ose i pjesshëm i infrastrukturës ose fizik i aseteve, Humbje=vlera e prodhimit ose të ardhurave të reduktuara ose kosto të shtuara dhe të paparashikuara për ofrimin e të njëjtit shërbim.

³⁴PDNA, Total Damages and Losses, pg.7

Figura. 4



Burimi: MSHR

Burimet potenciale të financimit janë kontributet financiare dhe/ose në natyrë të siguruara nga:³⁵

- Program special në buxhetin e shtetit;
- Njësitë e Qeverisjes Vendore;
- Qeveritë e huaja;
- Organizatat ndërkombëtare;
- Organizatat jofitimprurëse;
- Individët dhe entitetet;
- Bankat dhe institucionet e tjera financiare.

Në funksion të programit të rindërtimit, u krijua Fondi i Rindërtimit, i cili është në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit dhe konsiston në:

- programin e veçantë në buxhetin e shtetit që krijohet nga të ardhura nga buxheti i shtetit dhe të ardhura nga donatorë;
- dhurimet e mallrave apo shërbimeve nga donatorët, që përbëjnë kontribute në natyrë;
- Procedurat e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do të ndahet fondi, si dhe njësitë zbatuese, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Ndarja dhe Ekzekutimi i Buxhetit

Organet drejtuese janë:

- a) Këshilli i Ministrave;
- b) Komisioni Shtetëror për Rindërtimin;
- c) Ministri i Shtetit për Rindërtim;
- d) Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile ("NACP");
- e) Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore;
- f) Njësitë zbatuese (dmth. ministrinë e linjës ose agjencitë qeveritare);

³⁵ PDNA PG.6

Korniza ligjore:

Akti Normativ Nr.9, datë 16.12.2019, ò Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreë rregullon funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.³⁶

Sipas përcaktimeve të Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019, òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreë, Këshilli i Ministrave miraton propozimet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.Këshilli i Ministrave miraton përdorimin e fondit të rindërtimit nga njësitë zbatuese dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe përcaktimin e njësive zbatuese për projektet në kuadër të procesit të rindërtimit,³⁷ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për qëllimet dhe sipas parashikimeve të përcaktuara në këtë akt normativ.

Komisioni Shtetëror për Rindërtimin ushtron këto kompetenca:

- Harton dhe i propozon Këshillit të Ministrave programin e përgjithshëm të rindërtimit;
- Bashkërendon veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, përfshirë dhe donatorët, në përputhje me programin e përgjithshëm të rindërtimit, si dhe me procesin e rindërtimit;
- Siguron informimin e publikut dhe transparencën mbi procesin e rindërtimit.

Njësia zbatuese administron fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave prej fondit të rindërtimit, përfshi dhe kontributet në natyrë, dhe është përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit³⁸.

NjVQV administrojnë fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave prej fondit të rindërtimit, përfshi dhe kontributet në natyrë, kur caktohen si njësi zbatuese me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ministritë e linjës dhe Agjencitë e tjera qeveritare mund të jenë njësi zbatuese. Sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, ata marrin masa mbrojtëse, masa parandaluese dhe menaxhuese dhe kryejnë buxhetimin e tyre. Këshilli i Ministrave, me kërkesë të ministrisë përgjegjëse, mund të vendosë të financojë një ose më shumë masa nga fondi i rindërtimit. Referuar Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreë Neni 14, pika 5 òdhë dhe òeë, Programi i përgjithshëm i rindërtimit përmban të paktën të dhëna për:

- vlerën e dëmeve të shkaktuara, për aq sa është e mundur;
- masat që rekomandohen të merren në kuadër të programeve të procesit të rindërtimit dhe buxhetet e përafërta, nëse ka.

Implementimi i masave në funksion të procesit të rindërtimit:

Megjithëse PDNA mbetet i vetmi dokument zyrtar orientues, ai nuk ka shërbyer dhe nuk mund të shërbejë si një plan veprimi që do të përmbante sektorët prioritarë ku do të ndërhyet, afatet kohore në të cilën do të shtrihen projektet dhe investimet, planifikimin e fondeve për çdo aktivitet. Ekzistenca e një plani veprimi me indikatorë të matshëm, aktivitete të detajuara, afate kohore të mirëpërcaktuara dhe struktura përgjegjëse për çdo aktivitet do të shërbente për përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficient të fondit të rindërtimit. Në Progres Raportin e BE 2020 për Shqipërinë citohet: *Në kuadrin e premtimeve të larta të donatorëve në konferencën pas tërmetit, e organizuar nga Komisioni Evropian në Bruksel më 17 shkurt 2020, Shqipëria duhet gjithashtu të hartojë urgjentisht një plan financimi dhe veprimi për zbatimin e masave të Mbrojtjes Civile dhe*

³⁶ Akt Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, ò Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreë Neni 1,

³⁷ Akt Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, ò Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreë Neni 13, pika i/iii

³⁸ Akt Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, ò Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreë Neni 16, pika 1

*masa për zvogëlimin e riskut nga katastrofat në strategjinë e rikuperimit nga tërmeti, e cila përfshin gjithashtu edhe masat kryesore strukturuese kombëtare*³⁹.

Gjetje

14. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit nuk ka hartuar dhe propozuar Këshillit të Ministrave, masat që duhet të merren në kuadër të programeve të procesit të rindërtimit dhe buxhetet e përafërta në referencë të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në Neni 14, pika 5, gërma òeò.

Konkluzion

12. Mungesa e hartimit të një dokumenti planifikimi të fondeve që do të përdoren për procesin e rindërtimit, nuk premtion efikasitetin e përdorimit të tyre.

Rekomandim

14.1. KSHR të hartojë dhe propozojë në Këshillin e Ministrave, masat që duhet të merren në kuadër të programeve të procesit të rindërtimit dhe buxhetet e përafërta në përputhje me Aktin Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në Neni 14, pika 5, gërma òeò,

Deri në Prill 2022

Planifikimi i fondit të rindërtimit

Procesi i planifikimit të buxhetit të rindërtimit për vitet 2020 dhe 2021, nuk ka qenë i qartë për grupin e auditimit. Nga përgjigjet e pyetësorëve gjatë fazës së terrenit lidhur me mënyrën si planifikohet fondi i rindërtimit për vitin pasardhës dhe cila është struktura e cila kryen planifikimin, MFE ka orientuar grupin e auditimit për këtë informacion të referohet MSHR, ndërkohë që MSHR shprehet: *òlogjika e planifikimi nuk është njësoj si në situata normale, pasi jemi përpara një fatkeqësie natyrore e cila ka një proces funksionimi ndrysheò, pa sqaruar rolin që MSHR ka në këtë proces. Vihet re një mungesë bashkëpunimi dhe koordinimi mes dy subjekteve të sipërpërmendura sa i takon përgjegjësi që kanë. Gjithashtu është evidentuar se nuk ka një bazë ligjore e cila të përcaktojë qartë rolet dhe përgjegjësitë e strukturave në planifikimin e fondit të rindërtimit, mbledhjen e kërkesave për fonde, prioritizimin e sektorëve, buxhetet përkatëse etj. Nga sa është evidentuar gjatë auditimit, autoritetet përgjegjëse përfshirë Njësitë Zbatuese apo NJVQV paraqitin pranë Komisionit Shtetëror për Rindërtim, kërkesat e tyre për miratimin dhe zbatimin e programeve të rindërtimit, bazuar në problematikat dhe/ose nevojat e evidentuara në territoret e prekura nga fatkeqësia natyrore me qëllim rehabilitimin, rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja për individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë, institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre. Pra çdo kërkesë për fonde trajtohet rast pas rasti nga KSHR, po në të njëjtën mënyrë kryhet edhe shpërndarja e fondeve, rast pas rasti me vendimmarrjen e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe më tej me Vendimmarrje në Këshillin e Ministrave, ku përcaktohet objekti, fondi dhe njësia zbatuese që do të jetë përfituese.*

Gjetje

15. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministri i Shtetit për Rindërtim nuk janë koordinuar midis tyre me qëllim përgatitjen e projekt buxhetit të fondit të rindërtimit. Nuk del qartë cila është struktura që përgatit këtë dokument dhe bazuar mbi çfarë. Gjithashtu nuk ka patur evidencë në lidhje me planifikimin afatgjatë ose afatmesëm të fondit të rindërtimit. Mungesa e planifikimit

³⁹ Progres Raporti BE për Shqipërinë 2020

afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të fondeve që do të përdoren për rindërtimin nuk krijon mundësi për prioritizimin e sektorëve ku do ndërhyet, investime të gabuara dhe përdorim jo eficient të fondeve.

Konkluzion

13. Si në çdo rast tjetër përgatitja e projekt buxhetit kryhet nga MFE bazuar në kërkesat për fonde rindërtimi të planifikuara për t'u alokuar gjatë vitit pasardhës sipas programeve të rindërtimit. Mungesa e planifikimit të fondeve që do të përdoren gjatë procesit të rindërtimit, si në rastin e planifikimit afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë krijon mundësi për përdorim jo eficient të tyre.

Rekomandim

15.1 Ministria e Financave dhe Ekonomisë bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Rindërtim, të nisë procesin e planifikimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të fondit të rindërtimit bazuar në kërkesat e grumbulluara dhe prioritizimin e programeve të rindërtimit, me qëllim përdorimin eficient të fondeve.

Deri në prill 2022

Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit

Ligji nr.88/2019 për Buxhetin e vitit 2020 i ndryshuar, përcaktoi Fondin e Rindërtimit në masën 32 miliardë lekë në nivel total vjetor, ndërkohë që Neni 7 përcakton përdorimin i tij si më poshtë: Fondi i Rindërtimit prej 32 miliardë lekë, i cili përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, përbëhet nga:

- Grante 3 miliardë lekë
- Shpenzime të buxhetit të shtetit 29 miliardë lekë

Në zbatim të Ligjit për buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar, dhe përcaktimeve për Fondin e Rindërtimit si më sipër, në Udhëzimin Plotësues nr.2, datë 20.01.2020, në paragrafin 27 është përcaktuar se Fondi i Rindërtimit do të përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019. Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do të alokohet fondi si dhe institucionet dhe agjencitë, zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen në vitin pasardhës dhe do të përdoren për të njëjtin qëllim.

Me Ligjin e buxhetit nr. 137/2020 për buxhetin e vitit 2021, të ndryshuar, në nenin 7 të tij është përcaktuar se Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 28 miliardë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara në vitin 2020, si dhe për projektet e reja. Me qëllim evidentimin e saktë të shpenzimeve për rindërtimin, raportimi i përdorimit të këtyre fondeve është bërë në përputhje dhe sipas përcaktimeve në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23038, datë 10.12.2020. Sistemi i fondit të rindërtimit të pasojave të tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 sipas kodeve të produkteve specifike. Sipas kësaj shkrese të gjitha fondet e akorduara për rindërtimin do të pajisen me kode produkti specifike vetëm për rindërtimin, duke mundësuar në këtë mënyrë edhe gjenerimin e raporteve të këtyre të dhënave nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë. Raportimi i shpenzimeve faktike për rindërtimin bëhet si zë më vete në raportimin e Treguesve Fiskalë të Buxhetit të Konsoliduar, si periodike ashtu edhe vjetore.

Nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve të fazës së terrenit rezultoi se MSHR dhe MFE nuk disponojnë të dhëna për fondet totale të alokuara ndarë sipas programeve të rindërtimit. Ndërsa Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës kanë raportuar të dhëna si më poshtë:

Bashkia Tiranë


Fondet e alokuara dhe përdorur për Bashkinë Tiranë, ndarë sipas programeve të rindërtimit janë si më poshtë:

Tabela nr.7 Fondet e alokuara/përdorura nga Bashkia Tiranë sipas programeve të rindërtimit për periudhën 2020- 30.06.2021.

Programet e Procesit	Viti 2020		Viti 2021 (deri në 30.06.2021)	
	Fondet e alokuara	Fondet e përdorura	Fondet e alokuara	Fondet e përdorura
Programi i zhvillimit të objekteve të reja	1,136,002,934	0	2,126,236,561	466,065,460
Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike	500,000,000	14,852,473	1,419,512,804	87,083,086
Programi i krijimit të fondit të banesave	1,264,902,747	515,483,267	1,749,419,480	661,726,610
Programi i granteve të rindërtimit	1,232,875,000	1,089,025,000	2,358,020,112	666,343,079
Programi i masave të rimëkëmbjes sociale ekonomike (plane vendore / hartim projekti/shpronësim)	459,604,344	175,254,033	291,072,180	75,401,162
Programi i ndërtimit objekte arsimore	1,326,264,955	359,471,790	4,895,586,338	1,198,896,081
Totali	5,919,649,980	2,154,086,563	12,839,847,475	3,155,515,478


Burimi: Bashkia Tiranë

Grafiku nr.4 Raporti (%) Fonde të alokuara/ Fonde të përdorura për vitin 2020



Burimi: Bashkia Tiranë, Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku nr.5 Raporti (%) Fonde të alokuara/ Fonde të përdorura për vitin 2021(deri më 30.06.2021)



Burimi: Bashkia Tiranë, Përpunoi: Grupi i auditimit

Sipas raportit nga MSHR ende nuk ka nisur programi i mbështetjes sociale, i cili do të planifikojë fonde për skemën e mbështetjes së ndihmës ekonomike në zonat e prekuar nga fatkeqësia (përfitim papunësie, mbështetje financiare të shoqërive tregëtare), ndërkohë nga Bashkia Tiranë raportohen fonde të alokuara dhe përdorura për këtë program. Vihet re një mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi mes subjekteve në këtë rast, i cili sjell raportime që nuk korespondojnë me njëra tjetrën.

Gjetje

16. Programi i rimëkëmbjes ekonomike i cili përfshin edhe mbështetjen financiare për përfitim papunësie, mbështetje financiare të shoqërive tregëtare nuk ka nisur ende. Nuk ka asnjë parashikim për afatet kur duhet të kryhet planifikimi i fondeve që do të përdoren për këtë program dhe periudha e shtrirjes së tij, duke krijuar në këtë mënyrë një impakt direkt mbi ecurinë e shoqërive tregëtare të dëmtuara apo individëve që duhet të kishin përfituar nga pagesat e përfitimit të papunësisë.

Konkluzion

14. Programi i rimëkëmbjes ekonomike ka impakt direkt mbi individët e dëmtuar dhe shoqëritë tregtare, mungesa e tij shkakton vështirësi në procesin e rikuperimit.

Rekomandim

16.1. MSHR në bashkëpunim me MFE dhe NJVQV të propozojë hartimin e projektbuxhetit për programin e rimëkëmbjes ekonomike dhe shtrirjen e tij me afate të mirëpërcaktuara kohore.

Deri në prill 2022

Gjetje

17. Në raportimin e kryer nga ana e Bashkisë Tiranë rezultojnë fonde të alokuara për më shumë se pesë programe të përcaktuara në nenin 18 të Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Bashkia Tiranë nuk i ka detajuar fondet sipas pesë programeve të rindërtimit bazuar në nenin 18 të këtij akti. Programi i ndërtimit të objekteve arsimore nuk është ndarë sipas klasifikimit për programet e rindërtimit dhe zërat plane vendore, hartim projekti, shpronësim, janë identifikuar si pjesë e programit të rimëkëmbjes sociale nga ana e Bashkisë Tiranë.

Konkluzion

15. Neni 18 në Aktin Normativ Nr.9 datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, Neni 18 përcakton programet e procesit të rindërtimit.

- ✓ Programi i zhvillimit të objekteve të reja
- ✓ Programi i ndërtimit të infrastrukturës
- ✓ Programi i krijimit të fondit të banesave
- ✓ Programi i granteve të rindërtimit
- ✓ Programi i masave të rimëkëmbjes sociale ekonomike

Pasqyrimi i detajuar i fondeve sipas zërave në programet përkatëse ndihmon në identifikimin dhe menaxhimin më të mirë të fondeve dhe në rritjen e efikasitetit të përdorimit të tyre.

Rekomandim

17.1. Bashkia Tiranë të marrë masa për identifikimin dhe përfshirjen e zërave të plane vendore, hartim projekti, shpronësim, ndërtimi i objekteve arsimore, në përputhje me përcaktimin në Aktin Normativ Nr.9 datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

Deri në prill 2022

Fondet e alokuara ndarë sipas sektorëve të dëmtuar në Bashkinë Tiranë rezultojnë si më poshtë:

Tabela nr.8: Fondet e alokuara/përdorura sipas sektorëve të dëmtuar Bashkia Tiranë.


Sektorët e dëmtuar nga tërmeti 2019	Viti 2020		Viti 2021	
	Fondet e alokuara	Fondet e përdorura	Fondet e alokuara	Fondet e përdorura
Shëndeti				
Arsimi	1,326,264,955	359,471,790	4,895,586,338	1,198,896,081
Banesa	1,264,902,747	515,483,267	1,749,419,480	661,726,610
Prodhimtaria				
Infrastruktura	1,636,002,934	14,852,473	3,545,749,365	553,148,546

Mbrojtja sociale	1,089,025,000	1,089,025,000	1,572,680,322	666,343,079
Mbrojtja Civile	556,085,750	175,254,033	1,022,321,507	34,759,000
Shpronetime	47,368,594	-	54,090,463	40,642,162
Totali	5,919,649,980	2,154,086,563	12,839,847,475	3,155,515,478

Burimi: Bashkia Tiranë

- a. PDNA në faqen 8 Tabela 2(Damageandlossesbymunicipality) detajon sipas sektorëve të dëmtuar vlerën e dëmeve dhe humbjeve sipas NJVQV.

Grafiku nr.6. Paraqitja grafike e sektorëve të dëmtuar në Bashkinë Tiranë sipas PDNA.



Burimi: PDNA, Përpunoi: Grupi i auditimit

Sektorët më të dëmtuar sipas PDNA janë sektori i banesave, pasuar nga sektorët e arsimit, prodhimitarisë, infrastruktuës.


Tabela nr.9: Fondet e alokuara/ Vlerësimi dëm+humbje sipas PDNA për Bashkinë Tiranë

Sektorët e dëmtuar nga tërmeti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Totali I fondeve alokuar (2020/2021)	Sipas PDNA (dëme+humbje)	Raporti fonde alokuar total/ vl. PDNA(%)
	Fondet e alokuara	Fondet e alokuara			
Shëndeti			-	262,217,910	0%
Arsimi	1,326,264,955	4,895,586,338	6,221,851,293	5,670,308,420	110%
Banesa	1,264,902,747	1,749,419,480	3,014,322,227	26,385,523,310	11%
Prodhimtaria			-	2,697,274,370	0%

Infrastruktura	1,636,002,934	3,545,749,365	5,181,752,299	1,915,544,920	271%
Mbrojtja sociale	1,089,025,000	1,572,680,322	2,661,705,322	7,386,420	360%
Mbrojtja Civile	556,085,750	1,022,321,507	1,578,407,257	418,563,800	377%
Shpronësime	47,368,594	54,090,463	101,459,057	-	
Totali	5,919,649,980	12,839,847,475	18,759,497,455	37,356,819,150	50.22%

Burimi: PDNA, Bashkia Tiranë, Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku nr. 7 Raporti mes fondeve të alokuara për periudhën 2020-2021 dhe vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve sipas PDNA, për Bashkinë Tiranë.



Shpërndarja e fondeve të alokuara në Bashkinë Tiranë, nëpërmjet një analize integrale lidhur ngushtë me raportin e PDNA rezulton si më poshtë detajuar sipas sektorëve:

- Vlerësimi sipas PDNA në sektorin e shëndetit për Bashkinë Tiranë është 262,217,910 lekë, vlerë e cila përfaqëson 0.7% të vlerës totalë të dëmeve dhe humbjeve. Nga të dhënat e raportuara nga Bashkia Tiranë për këtë sektor nuk janë alokuar fonde për gjithë periudhën 2020-2021.
- Vlerësimi sipas PDNA në sektorin e arsimit për Bashkinë Tiranë është 5,670,308,420 lekë, vlerë e cila përfaqëson 15.2% të vlerës totalë të dëmeve dhe humbjeve. Nga të dhënat e raportuara nga Bashkia Tiranë për këtë sektor janë alokuar fonde në total për vitin 2020 dhe 2021 në vlerën 6,221,851,293lekë. Pra fondet e alokuara në total janë më të larta se niveli i dëmit dhe humbjeve raportuar nga PDNA për sektorin e arsimit.
- Vlerësimi sipas PDNA në sektorin e banesave për Bashkinë Tiranë është 26,385,523,310 lekë, vlerë e cila përfaqëson 70.6% të vlerës totalë të dëmeve dhe humbjeve. Nga të dhënat e raportuara nga Bashkia Tiranë për po këtë sektor janë alokuar fonde në total për vitin 2020 dhe 2021 në vlerën 3,014,322,227 lekë. Pra totali i fondeve të alokuara në këtë sektor, i cili është edhe sektori më i dëmtuar, përfaqëson gati 11% të nevojave të vlerësuar nga PDNA.

- Vlerësimi sipas PDNA në sektorin e prodhimit të prodhimit për Bashkinë Tiranë është 2,697,274,370 lekë, vlerë e cila përfaqëson 7.2% të vlerës totale të dëmeve dhe humbjeve. Nga të dhënat e raportuara nga Bashkia Tiranë për këtë sektor nuk janë alokuar fonde për gjithë periudhën 2020-2021.
- Vlerësimi sipas PDNA në sektorin e infrastrukturës për Bashkinë Tiranë është 1,915,544,920 lekë, vlerë e cila përfaqëson 5.1 % të vlerës totale të dëmeve dhe humbjeve. Nga të dhënat e raportuara nga Bashkia Tiranë për këtë sektor janë alokuar fonde në total për vitin 2020 dhe 2021 në vlerën 5,181,752,299 lekë. Fondet e alokuara për këtë sektor janë më të mëdha se diferenca mes fondeve të alokuara në total për gjithë periudhën për sektorin e infrastrukturës dhe nevojave të vlerësuara nga PDNA është 3.266.207.379 lekë, më tepër se nevojat e sektorit.
Rezulton një mospërputhje mes masës së vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve nga PDNA dhe kërkesës së kryer nga Bashkia Tiranë për të përfitur fonde nga fondi i rindërtimit, për këtë sektor. Fondet e alokuara në total për gjithë periudhën 2020- 2021 tejkalojnë disa herë nevojat e vlerësuara nga PDNA për sektorin e infrastrukturës.
- Vlerësimi sipas PDNA në sektorin e mbrojtjes sociale për Bashkinë Tiranë është 7,386,420 lekë, vlerë e cila përfaqëson 0.02 % të vlerës totale të dëmeve dhe humbjeve. Nga të dhënat e raportuara nga Bashkia Tiranë për këtë sektor janë alokuar fonde në total për vitin 2020 dhe 2021 në vlerën 2,661,705,322 lekë. Diferenca mes fondeve të alokuara në total për gjithë periudhën për sektorin e infrastrukturës dhe nevojave të vlerësuara nga PDNA është 2.654.318.902 lekë (më tepër se nevojat e sektorit). Rezulton një mospërputhje mes masës së vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve nga PDNA dhe kërkesës së kryer nga Bashkia Tiranë për të përfitur fonde nga fondi i rindërtimit, për këtë sektor. Fondet e alokuara në total për gjithë periudhën 2020- 2021 tejkalojnë disa herë nevojat e vlerësuara nga PDNA për sektorin e mbrojtjes sociale.
- Vlerësimi sipas PDNA në sektorin e mbrojtjes civile për Bashkinë Tiranë është 418,563,800 lekë, vlerë e cila përfaqëson 1.12 % të vlerës totale të dëmeve dhe humbjeve. Nga të dhënat e raportuara nga Bashkia Tiranë për këtë sektor janë alokuar fonde në total për vitin 2020 dhe 2021 në vlerën 1,578,407,257 lekë. Diferenca mes fondeve të alokuara në total për gjithë periudhën për sektorin e mbrojtjes civile dhe nevojave të vlerësuara nga PDNA është 1,159,843,457 lekë (më tepër se nevojat e sektorit). Rezulton një mospërputhje mes masës së vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve nga PDNA dhe kërkesës së kryer nga Bashkia Tiranë për të përfitur fonde nga fondi i rindërtimit, për këtë sektor. Fondet e alokuara në total për gjithë periudhën 2020- 2021 tejkalojnë disa herë nevojat e vlerësuara nga PDNA për sektorin e mbrojtjes civile.

Si konkluzion:

- ✓ Janë alokuar fonde të cilat tejkalojnë vlerën e dëmeve dhe humbjeve sipas PDNA në sektorët e mëposhtëm:
 - Sektori i arsimit në masën 110%
 - Sektori i infrastrukturës në masën 271%
 - Sektori i mbrojtjes sociale në masën 360%
 - Sektori i mbrojtjes civile në masën 377%
- ✓ Nuk ka patur asnjë alokim fondi megjithëse ka patur një vlerësim të dëmeve dhe humbjeve sipas PDNA në sektorët e mëposhtëm:


Sektori i shëndetit

Sektori i prodhimit të prodhimit

- ✓ Ka patur alokim fondesh në masën 11% duke ju referuar nevojave të identifikuara nga PDNA për sektorin e banesave megjithëse ky sektor ka qenë më i dëmtuari. Masa e dëmtimit është 70.6% në raport me totalin e dëmeve dhe humbjeve të vlerësuara nga PDNA.

Nga evidenca e grumbulluar gjatë fazës së terrenit për të gjitha subjektet nën auditim ka rezultuar mungesë e një analize të thelluar të dokumentuar në lidhje me procesin e rindërtimit, përdorimin e fondeve, ecurinë e procesit, identifikimi i problematikave etj.

Grafiku nr.8 Raporti mes Fondeve të alokuara në total për periudhën 2020-2021 Bashkia Tiranë dhe vlerësimit total të dëmit dhe humbjeve sipas PDNA



Burimi: Bashkia Tiranë, PDNA, Përpunoi: Grupi i auditimit

Fondet e alokuara për Bashkinë Tiranë nga fondi i rindërtimit përfaqësojnë rreth 50% të nevojave (dëme+humbje) bazuar në vlerësimin e PDNA.

Gjetje

18. Referuar PDNA, (fq.8 Table2Damageandlossesbymunicipality), Bashkia Tiranë nuk ka kryer planifikimin e kërkesave për fonde, në raport të drejtë me masën e dëmeve dhe humbjeve sipas sektorëve. Rezultojnë fonde të alokuara të cilat tejkalojnë disa herëvlerën e dëmit dhe humbjeve të vlerësuara nga PDNA në sektorët e arsimit, infrastrukturës, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes civile. Nuk rezultojnë fonde të alokuara në sektorët e dëmtuar, òshëndetiò dhe òprodhimtariaò, ndërkohë që vlerësimi i dëmit sipas PDNA për këta sektorë është respektivisht:

- ò Shëndeti 262,217,910 lekë
- ò Prodhimtaria 2,697,274,370 lekë

Konkluzion

16. Vlerësimi i dëmeve dhe humbjeve nga PDNA është i vetmi dokument orientues në funksion të procesit të rindërtimit, i cili shërben si udhërrëfyes për planifikimin dhe prioritizimin e sektorëve ku do ndërhyet për të garantuar një shpërndarje të drejtë të fondeve. Si rrjedhim, planifikimi dhe prioritizimi i sektorëve nëpërmjet një plani veprimi me afate të mirëpërcaktuara do të shërbente për përdorimin me efikasitet të fondeve të rindërtimit.

Rekomandim

18.1. Bashkia Tiranë nëpërmjet një analize të thelluar të rishikojë përdorimin e fondeve të rindërtimit për periudhën 2020-2021 dhe të kryjë planifikim e kërkesave për fonde për

periudhën në vazhdim, bazuar në prioritizimin e sektorëve ku do ndërhyet dhe duke marrë në konsideratë masën e dëmtimeve dhe humbjeve sipas sektorëve të përcaktuar nga PDNA.

Deri në prill 2022

18.2 MSHR të mbajë në konsideratë që në kërkesat që vijnë nga Bashkia Tiranë për fonde për rindërtimin ti shqyrtojë këto kërkesa në përputhje me vlerësimin e kryer nga PDNA për dëmet dhe humbjet sipas sektorëve përkatës.

Deri në prill 2022


Bashkia Durrës

Tabela nr.10 Fondet e alokuara/përdorura nga Bashkia Durrës sipas programeve të rindërtimit për periudhën 2020- 30.06.2021

Sektorët e dëmtuar nga tërmeti 2019	Viti 2020		Viti 2021	
	Fondet e alokuara	Fondet e përdorura	Fondet e alokuara	Fondet e përdorura
Shëndeti				
Arsimi				
Banesa	1.406.002.402		835.060.995	2.129.062.718
Prodhimtaria				
Infrastruktura				
Mbrojtja sociale				
Mbrojtja Civile				
Totali				


Burimi: Bashkia Durrës

Grafiku nr.9 Raporti fonde të alokuara/fonde të përdorura për vitin 2020 Bashkia Durrës



Burimi: Bashkia Durrës, Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku nr.10 Raporti fonde të alokuara/fonde të përdorura për vitin 2021 Bashkia Durrës



Burimi: Bashkia Durrës, Përpunoi: Grupi i auditimit

Fondet e alokuara për Bashkinë Durrës gjatë vitit 2020 për sektorin e banesave janë përdorur në vitin 2021 në përputhje me Udhëzimin Plotësues nr.2, datë 20.01.2020, paragrafi 27 sipas të cilit: *“Fondi i Rindërtimit do të përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019. Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do të alokohet fondi si dhe institucionet dhe agjencitë, zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen në vitin pasardhës dhe do të përdoren për të njëjtin qëllim.”*


- b. PDNA në faqen 8 Tabela 2(Damage and losses by municipality) detajon sipas sektorëve të dëmtuar vlerën e dëmeve dhe humbjeve sipas NJVQV. Në tabelën e mëposhtme paraqitet edhe vlerësimi i kryer nga PDNA i dëmeve dhe humbjeve sipas sektorëve.

Tabela nr. 11 Fondet e alokuara/ Vlerësimi dëmë+humbje sipas PDNA për Bashkinë Durrës.

Sektorët e dëmtuar nga tërmeti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Totali i fondeve alokuar (2020/2021)	Sipas PDNA (dëme+humbje)	Raporti fonde alokuar total/ vl. PDNA(%)
	Fondet e alokuara	Fondet e alokuara			
Shëndeti			-	184,660,500	
Arsimi				1,200,293,250	
Banesa	1,406,002,402	835,060,995	2,241,063,397	27,179,563,460	8%
Prodhimtaria			-	8,020,421,050	
Infrastruktura				1,101,807,650	
Mbrojtja sociale				7,386,420	
Mbrojtja Civile				492,428,000	
Totali	1,406,002,402	835,060,995	2,241,063,397	38,186,560,330	

Burimi: PDNA Bashkia Durrës, Përpunoi: Grupi i auditimit


Grafiku nr.11 Vlerësimi i dëmeve dhe humbjeve sipas sektorëve nga PDNA për Bashkinë Durrës



Burimi: PDNA Përpunoi: Grupi i auditimit

Sektori më i dëmtuar siç edhe shihet nga grafiku është sektori ishëndetësisë, pasuar nga prodhimtaria, arsimi dhe infrastruktura.

Grafiku nr.12 Raporti mes fondeve të alokuara për periudhën 2020-2021 dhe vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve sipas PDNA, për Bashkinë Durrës.



Burimi: Bashkia Durrës, PDNA, Përpunoi: Grupi i auditimit

Fondet e alokuara për Bashkinë Durrës kanë qënë vetëm për sektorin e banesave në vlerën totale 2,241,063,397 lekë për gjithë periudhën 2020-2021, kundrejt vlerës 38,186,560,330 lekë që është vlerësimi sipas PDNA. Në total fondet e alokuara për Bashkinë Durrës përfaqësojnë rreth 5.9 % të vlerës së dëmit dhe humbjeve sipas PDNA për këtë Bashki.

Subvencionimi i pagesës së qirasë

Në lidhje me subvencionimin e qirave nga ana e NJQV grupi i auditimit mori kampion Bashkinë Durrës dhe analizoi praktikën e ndjekur nga ky subjekt lidhur me listën e përfituesve.

Referuar neni 2, Aktit Normativ Nr. 8 datë 07.12.2019 Për përdorimin e Procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, NJVQV ngarkohen:

- Të hartojnë listat e familjeve banesat e të cilave janë shembur ose janë klasifikuar si të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit.
- Të vlerësojnë nivelin mesatar të qirasë për struktura të ndryshme apartamentesh, brenda 5 ditëve pune nga hyrja në fuqi e aktit normativ.

Nga shqyrtimi i evidencës së grumbulluar rezultoi se numri i familjeve që kanë aplikuar dhe janë miratuar paraprakisht me VKB për të përfituar nga subvencionimi i qirasë është 6,192, ndërsa numri i familjeve përfituese të bonusit të qirasë është 5,270 familje. Diferenca 922 familje rezulton e skualifikuar. Sipas Bashkisë Durrës arsyet e moskualifikimit të familjeve kanë qënë: *“Pas verifikimit të objekteve nga grupet e akt konstatimit të cilët kanë rezultuar të banueshëm, këtyre banorëve nuk i është bërë likuidimi i bonusit të qirasë.”* Nga analiza që grupi i auditimit i bëri listës së familjeve që kanë aplikuar për të përfituar subvencionimin e qirasë por nuk janë shpallur fitues rezultoi:

- 120 familje që kanë statusin e banesës me akt konstatim i pabanueshëm.
- 68 familje për të cilat rezulton statusi i pa inspektuar.

Gjithashtu grupi i auditimit mori si kampionë me përzgjedhje rastësore 4 aplikime nga 922 familjet e skualifikuara për përfitimin e bonusit të qirasë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tyre rezultoi:

- Aplikanti E.K., statusi i banesës: i pabanueshëm, plotëson dokumentacionin për të përfituar bonus, arsyeja e mospërfitimit nuk ka depozituar dokumentin për llogarinë bankare.

- Aplikanti A.M.D statusi i banesës: i pabanueshëm, plotëson dokumentacionin për të përfituar bonus, arsyeja e mospërfitimit nuk ka depozituar dokumentin për llogarinë bankare. Ky aplikant nuk ka depozituar dokumentin për llogarinë bankare.
- Aplikanti A.P.D, statusi i banesës: i pabanueshëm, plotëson dokumentacionin për të përfituar bonus, arsyeja e mospërfitimit nuk është e qartë.
- Aplikanti B.G. statusi i banesës: i pabanueshëm, plotëson dokumentacionin për të përfituar bonus, arsyeja e mospërfitimit nuk ka depozituar dokumentin për llogarinë bankare nuk ka depozituar dokumentin për llogarinë bankare.

Gjetje

19.Referuar nenit 2 të Aktit Normativ Nr. 8 datë 07.12.2019 Për përdorimin e Procedurës së përsheptuar për subvencionimin e qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, Bashkia Durrës nuk ka kryer testimin e tregut për të përcaktuar nivelin mesatar të qirasë. Në relacionin shoqëruar për VKB mungon dokumentacioni që argumenton testimin e tregut për të përcaktuar nivelin e qirasë sipas strukturave të banimit.

Konkluzion

17. Mungesa e testimit të tregut për përcaktimin e nivelit mesatar të qirave të banesave krijon mundësi për përdorimin jo eficient të fondeve të procesit të rindërtimit.

Rekomandim

19.1. Bashkia Durrës të marrë masa për testimin e tregut me qëllim përcaktimin e vlerave reale të qirave të banesave, dhe të propozojë ndryshimin e tyre (nëse do të jetë i tillë), për miratim në Këshillin Bashkiak.

Deri në prill 2022

Gjetje

20.Në Bashkinë Durrësjanë skualifikuar 922 familje të cilat kanë aplikuar për të përfituar bonusin e strehimit nga programi i subvencionimit të qirasë. Arsyet e skualifikimit për këto 922 familje, janë mungesa e të dhënave(numri i llogarisë bankare, vërtetim vendbanimi, etj) në dosjet përkatëse të aplikimit.Bashkia Durrës nuk ka kryer njoftime (të dokumentuara) për aplikantët që rezultojnë me mungesa të tilla në dokumentacion. Ndërkohë për 68 nga 922 familje, Bashkia Durrës nuk ka kryer ende inspektime për të verifikuar shkallën e dëmtimit të këtyre banesave.

Konkluzion

18. Procesi i identifikimit të dëmtimeve dhe inspektimeve në terren edhe pse ka qënë i vështirë duhet të kishte përfunduar nga ana e Bashkisë Durrës. Qëllimi i procedurës së përsheptuar që përcakton Aktit Normativ Nr. 8, datë 07.12.2019 Për përdorimin e Procedurës së përsheptuar për subvencionimin e qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, është ardhja në ndihmë familjeve që ju janë dëmtuar banesat nga tërmeti dhe janë në kushte të pabanueshme.

Rekomandim

20.1. Bashkia Durrës të marrë masa të menjëhershme për të siguruar inspektimet në terren për 68 familjet që rezultojnë me statusin i painspektuar dhe që kanë aplikuar për të përfituar nga subvencionimi i qirasë.

Menjëherë

20.2Bashkia Durrës t'ja japë prioritet shqyrtimit të listës së familjeve që kanë aplikuar për të përfituar nga subvencionimi i qirasë,të cilat rezultojnë me status banese òi pa banueshëm, dhe të

kryejë njoftimet për mungesat që ata kanë dokumentacionin e paraqitur, me qëllim finalizimin e procesit.

Menjëherë

Fondet e alokuara për subvencionimin e qirasë

Tabela nr. 12 Të dhëna për fondet e alokuara për subvencionimin e qirasë Bashkia Durrës

Viti	Llog. ekonomike	Emertimi	Plan i çelur (Lekë)	Fakt (Lekë)
2019	606	Subvencionimi i qerave per familjet e prekura nga termeti	52,268,000	24,943,000
2020	606	Subvencionimi i qerave per familjet e prekura nga termeti	1,180,586.32	1,164,602,500
1-30 prill 2021	606	Subvencionimi i qerave per familjet e prekura nga termeti	329,102,500	301,652,500
		Totali	1,561,956,816	1,491,198,000

Burimi: Bashkia Durrës

Analiza, monitorimi dhe auditimi

ISSAI 5510 Auditimi i fatkeqësisë dhe zvogëlimi i riskut, fq.35 citon nevojën e ngritjes së një mekanizmi për të mbikëqyrur zbatimin fizik dhe financiar të projekteve dhe investimeve, i cili do të shërbejë për të ndihmuar vendim marrësit të marrin në kohë masa korigjuese. Gjithashtu vlerësohet nevoja e raportimit periodik të përdorimit të fondeve të alokuara nga ana e përdoruesve të fondeve, analizave kosto përfitim ose të ngjashme me qëllim gjetjen e alternativave të reja realiste.(ISSAI5510 fq.36). Po ashtu PDNA te parimet udhëzuese citon nevojën e monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të fazave të ndryshme të procesit të rimëkëmbjes me qëllim sigurimin e një menaxhimi financiar efikas dhe eficient.⁴⁰ si edhe auditimin e brendshëm për çdo shpenzim të kryer në funksion të programeve të procesit të rindërtimit.⁴¹

Gjetje

21. Bazuar në ISSAI 5510 Auditimi i fatkeqësisë dhe zvogëlimi i riskut⁴², i cili vlerëson nevojën e ngritjes së një mekanizmi për monitorimin fizik dhe financiar të projekteve dhe investimeve, në mënyrë që të parandalohen investimet e panevojshme, konstatohet se për procesin e rindërtimit, ky mekanizëm mungon.

⁴⁰ PDNA, GuidingPrinciples, FQ.87, Article I

⁴¹ PDNA fq. 90

⁴²ISSAI 5510 The audit of disaster risk reduction, pg.35 (In order to prevent unnecessary investment in this field and to use resources efficiently, a mechanism should be established to monitor the physical and financial implementation of actions, projects and investments.)

Konkluzion

19. Parashikimi i mekanizmit të monitorimit të zbatimit fizik dhe financiar të projekteve dhe investimeve në procesin e rindërtimit do të parandalonte investime të panevojshme dhe do të ndikonte në përdorimin me eficiencë të fondeve.

Rekomandim

21.1 Ministri i Shtetit për Rindërtim në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit, të vlerësojë mundësinë e krijimit të mekanizmit për monitorimin e zbatimit fizik dhe financiar të projekteve dhe investimeve për procesin e rindërtimit, duke përfshirë edhe strukturën e cila do të kryejë gjithë procesin e monitorimit.

Deri në prill 2022

Gjetje

22. Bazuar te ISSAI 5510, Auditimi i fatkeqësisë dhe zvogëlimi i riskut.⁴³, KSHR, MSHR, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës, nuk kanë kryer analiza mbi kosto/përfitimin ose analiza të ngjashme, për secilin nga programet e procesit të rindërtimit. Analizimi i plotë i elementëve të koston së projekteve dhe investimeve gjatë procesit të rindërtimit do të krijonte një perspektivë më të qartë lidhur me alternativa të tjera realiste më eficiente në procesin e rindërtimit.

Konkluzion

20. Mungesa e analizës kosto përfitim për secilin nga programet e rindërtimit nuk krijon mundësi për gjetjen e alternativave të tjera reale dhe mund të dëmtojë përdorimin me eficiencë të fondeve.

Rekomandim

22.1. Ministri i Shtetit për Rindërtim në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit të vlerësojë mundësinë e kryerjes së analizave kosto përfitim ose të ngjashme për secilin nga programet e procesit të rindërtimit.

Deri në prill 2022

22.2. Bashkitë Tiranë dhe Durrës të vlerësojnë mundësinë e kryerjes së analizave kosto përfitim ose të ngjashme për secilin nga programet e procesit të rindërtimit.

Deri në prill 2022

Gjetje

23. Bazuar te ISSAI 5510, Auditimi i fatkeqësië dhe zvogëlimi i riskut⁴⁴ rezulton se mungon një formë e unifikuar raportimi periodik nga njësitë zbatuese apo NJVQV në lidhje me përdorimin e fondeve të alokuara, masën e realizimit të tyre dhe arsyet e mosrealizimit.

Konkluzion

21. Mungesa e një raportimi periodik nga ana e njësisë zbatuese shton edhe më shumë paqartësinë lidhur me përdorimin e fondeve, realizimin e projekteve apo investimeve të ndryshme. Një formë e unifikuar do të ndihmonte në rradhë të pare vetë subjektet e përfshira në realizimin dhe monitorimin e fondeve të rindërtimit por edhe subjekte të tjera kontrolluese si KLSH etj., për të arritur një vlerësim sa më objektiv dhe të drejtë.

⁴³ISSAI 5510 The audit of disaster risk reduction, page.36. (Does the government make use of cost-benefit and similar analyses to identify realistic alternatives?)

⁴⁴ISSAI 5510 The audit of disaster risk reduction, page.36. (Is there any periodic reporting on disaster fund allocation and utilization by recipient agencies?)

Rekomandim

23.1 MSHR të përgatisë një formë të unifikuar raportimi për të gjitha njësitë zbatuese apo NjVQV në lidhje me përdorimin e fondeve të alokuara.

Deri në prill 2022

Referuar PDNA, fq.90, çdo aktivitet ose shpenzim i kryer në kryerjen e programeve të procesit të rindërtimit do t'i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për pajtueshmërinë, financat dhe performancën, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike.

Gjetje

24.Referuar PDNA fq.90⁴⁵, subjektet nën auditim, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës nuk kanë iniciuar auditime të brendshme me objekt përdorimin e fondeve për rindërtim për periudhën 2020-2021.

Konkluzion

22. Mungesa e kontrollit të brendshëm në procesin kompleks dhe sensitive të rindërtimit mund të dëmtojë efektivitetin dhe eficiencën e përdorimit të fondeve të procesit të rindërtimit.

Rekomandime

24.1. Drejtoritë e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Tiranë dhe Durrës të planifikojnë auditim të procedurave dhe fondeve që lidhen me procesin e rindërtimit.

Në vazhdimësi

4.3 A ka qenë efektive koordinimi i institucioneve përgjegjëse lidhur me tërmetin e 2019?

4.3.1 A kanë bashkëpunuar institucionet përgjegjëse lidhur me menaxhimin e tërmetit të 2019 me qëllim arritjen e rezultateve të synuara?

Për trajtimin e kësaj pyetjeje audituese janë përgatitur pyetësorë për të gjitha subjektet nën auditim për të evidentuar bashkëpunimin dhe koordinimin midis tyre me qëllim menaxhimin dhe përballimin e situatës së tërmetit të 2019. Shtetet i përcaktojnë politikat e tyre të menaxhimit të fatkeqësive për të krijuar përshtatshmëri sa i përket çënueshmërisë ndaj fatkeqësive natyrore. Menaxhimi i fatkeqësive natyrore është gjithashtu një përgjegjësi e përbashkët midis qeverisë, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Koordinimi efektiv midis këtyre aktorëve të ndryshëm është njëparakusht për menaxhimin e suksesshëm të fatkeqësive natyrore⁴⁶. Mos koordinimi dhe bashkëpunimi jo i mirëmidis këtyre aktorëve përveç se mund të ndikojë në tërësinë e procesit të menaxhimit të situatës së fatkeqësisë natyrore mund të çojë edhe në ndihma të paregjistruara. Ndihma e paregjistruar është ajo që merret por nuk regjistrohet në librat e marrësit. Kjo mund të jetë për shkak të agjencive të grumbullimit të cilat janë të paidentifikuara qartë, llogari të shumta, dështim nga autoritetet për të vënë në dispozicion informacion mbi mekanizmat e menaxhimit të ndihmës dhe koordinim i dobët midis agjencive të menaxhimit të fatkeqësive.⁴⁷

Kontributet në natyrë janë sende ose materialendërtimore, punë apo shërbime në funksion të procesit të rindërtimit. Këto kontribute merren në dorëzim nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, që bashkëpunon për këtë qëllim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit ose me kërkesë të kësaj Drejtorie me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe i vendosennë dispozicion njësisë zbatuese. Kontributet në natyrë, sende apo materiale ndërtimore magazinohen dhe inventarizohen nga autoriteti përgjegjës dhe lëvrimi i tyre bëhet me kërkesë të njësisë zbatuese

⁴⁵PDNA Audit and Monitoring page.90

⁴⁶ISSAI 5520, fq 8.

⁴⁷ISSAI 5520, fq 19.

dhe me miratim paraprak të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit. AKMC-ja informon Komisionin Shtetëror të Rindërtimit për çdo kontribut në natyrë. Gjithashtu, të gjitha kontributet në natyrë, duhet të publikohen në portalin e transparencës së procesit të rindërtimit.⁴⁸ Komisioni Shtetëror i Rindërtimit është përgjegjës për bashkërendimin dhe koordinim e veprimtarisë së institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, përfshirë dhe donatorët, në përputhje me programin e përgjithshëm të rindërtimit, si dhe me procesin e rindërtimit.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) mbledh, menaxhon, përpunon dhe analizontë gjitha aktet e vlerësimit paraprak, aktekspertizat e thelluara dhe çdo të dhënë tjetër mbi pasojat e fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësive të tjera, që i përcillen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet e tjera shtetërore. AKMC-ja edhe kryesisht mund verifikojë aktet e vlerësimit paraprak, aktekspertizat e thelluara, si dhe të dhënat e tjera të përcjella nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet e tjera shtetërore, si dhe mund të kërkojë informacione shtesë mbi këto të dhëna nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo autoritetet e tjera shtetërore ose drejtpërdrejt nga subjektet e interesuara.

Gjetje

25. Bashkia Tiranë ka marrë kontribute në natyrë ndërsa referuar përgjigjes së Bashkisë Durrës kjo e fundit nuk ka marrë kontribute në natyrë. Referuar Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ò neni 37, pika 8, AKMC duhet të informojë Komisionin Shtetëror të Rindërtimit për çdo kontribut në natyrë të regjistruar. Mos informimi ndaj KSHR ka ardhur si rezultat i mungesës së shkëmbimit të informacioneve për kontributet në natyrë midis Bashkisë Tiranë dhe AKMC.
26. Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës nuk kanë dërguar në AKMC të dhëna që lidhen me akt vlerësimit paraprake dhe akt vlerësimit e thelluara jo në përputhje me Aktin Normativ nr.9 datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ò neni 15 pika 1.

Konkluzione

23. Kontributet në natyrë janë një element shumë i rëndësishëm për përballimin e pasojave dhe efekteve që tërmeti ka lënë pas. Duke qenë se AKMC është hallka kryesore lidhëse dhe transmetuese e informacionit sa i përket kontributeve në natyrë, referuar Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ò neni 37, ajo duhet të sigurojë të dhëna nga subjektet përfituese të kontributeve në natyrë dhe duhet t'ja dërgojë këto të dhëna Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.
24. Duke qenë se Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe konkretisht Bashkitë Tiranë dhe Durrës të cilat janë edhe subjekte auditimi nuk kanë dërguar asnjë informacion në AKMC lidhur me akt vlerësimit paraprake dhe akt vlerësimit e thelluara të dëmeve të tërmetit 2019, kjo e fundit nuk ka asnjë të dhënë lidhur me këto akt vlerësime. Si rezultat i mungesës së këtyre të dhënave nga AKMC, ajo nuk ka mundur të verifikojë aktet e vlerësimit paraprak, aktekspertizat e thelluara, si dhe të dhënat e tjera të përcjella nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Rekomandime

- 25.1. AKMC të marrë masa që të sigurojë të dhëna për çdo kontribut në natyrë me qëllim përcjelljen e tyre në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit në përputhje me Aktin Normativ nr.9 datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ò neni 37, pika 8.

Deri në prill 2022 e në vazhdimësi

⁴⁸ Akti normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ò, neni 37.

26.1 Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës të marrin masat e nevojshme duke dërguar në AKMC të gjitha të dhënat që lidhen me akt konstatimet në përputhje me Aktin Normativ nr.9 datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në 15 pika 1.

Deri në prill 2022 e në vazhdimësi

4.3.2 A kanë patur në dispozicion institucionet përgjegjëse kapacitetet e duhura humane me qëllim menaxhimin e pasojave të tërmetit të 2019?

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 23, pika 7, e 26, pika 2, të ligjit nr. 45/2019, òPër mbrojtjen civile, dhe të ligjit nr. 90/2012, òPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave me Vendim Nr. 747, datë 20.11.2019 òPër organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile vendosi:

1. Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile me seli në Tiranë.
2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme.
3. Agjencia, në përmbushje të funksioneve dhe për zbatimin e detyrave të saj, siguron fonde nga donatorë të ndryshëm, vendas e ndërkombëtarë.
4. Agjencia ka për mision zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe sigurimin e mbrojtjes civile në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Agjencia ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie:
 - a) Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë;
 - b) Mbrojtja civile në nivel kombëtar;
 - c) Trajnimi i vazhdueshëm i strukturave shtetërore, i subjekteve private dhe i vullnetarëve;
 - ç) Inspektimi i zbatimit të dispozitave të legjislacionit për mbrojtjen civile në institucionet e strukturat shtetërore dhe subjektet private.

AKMC ka këto përgjegjësi:

- a) Të organizojë punën për analizimin e vlerësimin e situatës së riskut nga fatkeqësitë natyrore, reduktimin e tij dhe mbrojtjen civile;
- b) Të organizojë punën për ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile në nivel qendror e vendor, si dhe trajnimin e subjekteve private e vullnetare, nëpërmjet përgatitjes e zhvillimit të programeve të posaçme të trajnimit;
- c) Të zhvillojë procesin e inspektimit, duke garantuar respektimin e dispozitave të legjislacionit për mbrojtjen civile nga institucionet e strukturat shtetërore dhe subjektet private.

Struktura e AKMC është miratuar me anë të Urdhërit të Kryeministrit nr. 27, datë 3.2.2020 òPër miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Në pikën 7 të këtij Urdhëri është përcaktuar numri i përgjithshëm i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile duhet të jetë 106. AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe më pas kjo e fundit me Departamentin e Administratës Publike (DAP) ka vijuar procesin e rekrutimit për plotësimin e strukturës organike në nivel qendror dhe vendor. Periodikisht, AKMC ka hartuar dhe dërguar në DAP, planin e nevojave në shërbimin civil për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2020 dhe planin vjetor të nevojave në shërbimin civil për vitin 2021. Aktualisht janë rekrutuar gjithsej 60 punonjës nga 106 që janë në strukturën organike.

Në shpjegimet në lidhje me pyetësoret AKMC ka sqaruar se òProcedura e shpalljes dhe rekrutimit administrohet nga DAP dhe nuk ndikohet nga veprimtaria e AKMC-së, duke bashkëngjitur praktikat shkresore drejtuar DAP si më poshtë:

1. Shkresa nr. 238/2.prot., datë 27.5.2020 e AKMC-së për dërgimin e planit të detajuar të nevojave në shërbimin civil në aparatit e AKMC-së , për vitin 2020.
2. Shkresa nr.12201.prot., datë 28.10.2020 e AKMC-së për dërgimin e planit të detajuar të nevojave në shërbimin civil në aparatit e AKMC-së për vitin 2021.

Një çështje tjetër në të cilën grupi i auditimit është fokusuar në këtë pyetje auditimi janë edhe trajnimet. AKMC ka si pjesë të organikës së saj Drejtorinë e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit, në të cilën është dhe Sektori (Qendra) Kombëtare e Trajnimit për Mbrojtjen Civile, Edukimit dhe Vullnetarizmit, sektor i cili nuk është plotësuar dhe është në proces plotësimi me personel të strukturës organike.

Në përgjigjen e saj AKMC ka dërguar me email grupit të auditimit bashkëngjitur dokumentacionin si më poshtë:

- Trajtime për personelin e AKMC-së, në kuadrin e procesit të ristrukturimit të këtij institucioni.
- Trajnim midis AKMC-së dhe Qendrës për Menaxhimin e Krizave të Maqedonise nga data 02.02.2021 deri 06.02.2021 me temë: ÷Sistemi i Komandës së Incidentit të Gjeneratës së Tjetër (The Next-Generation Incident Command System, NICS)÷, në të cilin Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi në bashkëpunim me Qendrën e Menaxhimit të Krizave të Republikës së Maqedonisë Veriore, angazhuan për t'u trajnuar personelin e AKMC-së dhe të qendrave të mbrojtjes civile në qarqe, si dhe personelin e strukturave operacionale të stacioneve të PMNZSH-së të Bashkisë Tiranë.

Bashkia Durrës

Për periudhën objekt auditimi, grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion tre Vendime të Kryetarit të Bashkisë Durrës për miratimin e strukturës dhe rregullores së brendshme të Bashkisë Durrës.

- 1- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Durrës nr. 66 datë 07.05.2019 ÷Për ndryshimin e Strukturës dhe Rregullores së Bashkisë Durrës÷.
- 2- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Durrës nr. 583 datë 24.06.2020 ÷Për ndryshimin e Strukturës dhe Rregullores së Bashkisë Durrës÷.
- 3- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Durrës nr. 29 datë 09.04.2021 ÷Për ndryshimin e Strukturës dhe Rregullores së Bashkisë Durrës÷.

Referuar strukturës së Bashkisë Durrës, miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Durrës nr.66, datë 07.05.2019 ÷Për ndryshimin e Strukturës dhe Rregullores së Bashkisë Durrës÷ struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile ka qenë Sektori i Mbrojtjes Civile (i përbërë prej 8 punonjësish) pranë Drejtorisë së Mbrojtjes Civile, Bujqësisë, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar. Në strukturën e miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Durrës nr. 583, datë 24.06.2020 ÷Për ndryshimin e Strukturës dhe Rregullores së Bashkisë Durrës÷ Sektori i Mbrojtjes Civile i përbërë prej 8 punonjësish nuk ka pësuar ndryshime. Ndërsa me anë të Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Durrës nr. 29, datë 09.04.2021 ÷Për ndryshimin e Strukturës dhe Rregullores së Bashkisë Durrës÷, Sektori i Mbrojtjes Civile (i cili tashmë është me 9 punonjës) është bërë pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Nga verifikimi i strukturës sipas Vendimit Nr. 29, datë 09.04.2021 ÷Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës rezulton që ka rritje të personelit të strukture së mbrojtjes civile me vetëm një punonjës.

Me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Durrës në detyrë me nr. 108, datë 12.03.2020, është ngritur ÷Zyra e posaçme e rindërtimit, rikonstruksionit dhe rimëkëmbjes ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile÷, në zbatim të Aktit Normativ

nr.9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, në të cilin janë përcaktuar procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj zyre e cila vazhdon të jetë funksionale deri në përfundim të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit.

Kjo zyrë është e përbërë nga 9 punonjës të cilët kanë përveç detyrave të tyre funksionale, kryejnë edhe detyrën që përcaktohet në Urdhërin nr. 108, datë 12.03.2020.

Bashkia Tiranë

Në përgjigjen e saj Bashkia Tiranë ka theksuar se strukturat që kanë operuar në procesin e rindërtimit pas tërmetit të vitit 2019 janë si më poshtë:

- 27 Njësitë Administrative;
- Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social;
- Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar;
- Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike;
- Drejtoria për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin;
- Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike;
- Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik;
- Policia Bashkiake;
- Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit.

Për periudhën objekt auditimi Bashkia Tiranë ka vënë në dispozicion Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë me nr. 1042, datë 09.01.2018 òPër miratimin e strukturës dhe organikës së institucionit të Bashkisë Tiranë. Bazuar në këtë strukturë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile ka qenë pjesë edhe Drejtoria e Emergjencave Civile me një staf prej 4 punonjësish (1 Drejtor +3 specialistë). Me anë të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.17762, datë 30.04.2021 òPër miratimin e strukturës dhe organikës së institucionit të Bashkisë Tiranë janë shtuar drejtori dhe sektorë të tjerë që lidhen me procesin e rindërtimit. Konkretisht, në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile krahas Drejtorisë së Emergjencave Civile (e cila është shtuar me 4 specialistë të tjerë), është shtuar edhe Drejtoria e Rindërtimit të Emergjencave Civile me 8 punonjës (1 drejtor +7 specialistë). Gjithashtu në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit është shtuar Sektori i Planifikimit të Territorit për Rindërtimin me 5 punonjës. Në Drejtorinë e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit është shtuar Sektori i përgatitjes së aplikimeve të Lejeve për Rindërtim me një staf prej 6 punonjësish. Në Drejtorinë e Investimeve të Punëve Publike janë shtuar Sektori i Zbatimit të Rindërtimit të Punëve Publike (11 punonjës) dhe Sektori i Koordinimit të Rindërtimit të Punëve Publike (3 punonjës). Në total, pas tërmetit të 2019 me strukturën e re të Bashkisë Tiranë janë shtuar gjithsej 37 punonjës që janë ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi të ndryshme lidhur me procesin e rindërtimit.

Bashkia Tiranë ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit trajnimet e kryera si më poshtë:

- òProgrami i demonstrimit në terren mbi veprimet e ndërhyrjes për situatat emërgjente që mund të shkaktohen nga tërmeti - Shkolla òBetim Muçoò, Rr. Shaban Bardhoshi, Kombinat. Pjesëmarrjes: Përfaqësues të Prefekturës së Qarkut Tiranë, Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Policisë Bashkiake, Drejtorisë së Medias Bashkia Tiranë, Shkollës òBetim Muçoò (mësues-nxënës-prindër), Njesisë Administrative Nr.6, Qendrës Vullnetare të Emergjencave Civile datë 19.09.2019.
- Panairi i organizuar nga Bashkia Tiranë në datën 24-25-26 nëntor 2019 në kuadër të ekspozimit të burimeve njerëzore dhe asetëve të Drejtorisë së Emergjencave Civile.

- Data 22 korrik 2019 ó Tiranë - óSistemet e Komandimit të Incidentitö. Programi CBRN-Organizuar nga Ministria e Mbrojtjes me trajnues nga USA.
- Tetor 2019 ó FUSHË KRUIË - óJOINT REACTION - 2019ö. Organizuar nga Ministria e Mbrojtjes. Stërvitje e përbashkët e vendeve të Rajonit- Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Bosnje & Hercegovina, Mali i Zi.
- Bashkia Tiranë ka vënë ne dispozicion të grupit të auditimit me email foto nga kryerja e veprimeve stimuluese të emergjencave civile në shkollën öBetim Muçoö (Mësues- Nxënës-Prindër), Njësisë Administrative Nr.6, Qendrës Vullnetare të Emergjencave Civile datë 19.09.2019.

Gjetje

27. Aktualisht organika e AKMC numëron një staf prej 60 punonjësish. Organika e AKMC-së, nuk është plotësuar në përputhje me Urdhërin e Kryeministrit nr. 27., datë 3.2.2020, öPër miratimin e strukturës dhe organikës së AKMCö, pika 7, sipas së cilës numri i përgjithshëm i punonjësve të AKMC-së duhet të jetë 106 persona.
28. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile nuk ka kryer asnjë trajnim me Strukturat e Emergjencave/Mbrojtjes Civile, në Bashkinë Durrës siç përcaktohet në nenin 63 pika 1 të ligjit 45/2019 ku citohet :ö Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen trajnime për mbrojtjen civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, sipas programit dhe moduleve të miratuara më parë nga ministri për këtë qëllimösi dhe nenit 23 pika 6 gërma ë, ku citohet:öAKMC nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Trajnimeve për Mbrojtjen Civile, kryen trajnimet e strukturave shtetërore, të subjekteve private e vullnetareö.
29. Bashkia Durrës nuk ka organizuar veprimtari trajnuese lidhur me tërmetet për punonjësit dhe banorët në territorin e saj siç është përcaktuar në Ligjin nr. 45/2019 öPër mbrojtjen civileö neni 30 gërma ödö. Kjo ka sjellë mungesë të informimit dhe koordinimit të veprimeve në rastet e mundshme të ndodhjes së fatkeqësive natyrore.

Konkluzione

25. AKMC nuk ka plotësuar organikën e punonjësve në përputhje me Urdhërin e Kryeministrit nr. 27, datë 3.2.2020, öPër miratimin e strukturës dhe organikës së AKMCö, pika 7, sipas së cilës numri i përgjithshëm i punonjësve të AKMC-së duhet të jetë 106 vetë, në mënyrë që të ushtrjë autoritetin kordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 neni 23 pika 6 gërma ë. Mungesa në personel sjell mangësi në realizimin e detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësive që ka AKMC-ja si institucion.
26. Mungesa e theksuar në personel, 40 punonjës më pak se organika, ka sjellë mangësi në öTrajnimin për Mbrojtjen Civile, Edukimit dhe Vullnetarizmitö siç përcaktohet në ligjin 45/2019 datë 18.07.2019 datë 18.07.2019 neni 63 pika 1 öAgjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen trajnime për mbrojtjen civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, sipas programit dhe moduleve të miratuara më parë nga ministri për këtë qëllimö, si dhe neni 23 pika 6 gërma ë:öAKMC nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Trajnimeve për Mbrojtjen Civile, kryen trajnimet e strukturave shtetërore, të subjekteve private e vullnetareö. Duke qenëse nuk janë kryer trajnimet e nevojshme, potencialisht mundësia e shmangies së rrezikut nga emergjencat natyrore është në nivele jo të kënaqshme,si detyrë kryesore e AKMC. Trajnimet për emergjencat civile shërbejnë si mundësi e banorëve që të fitojnë aftësitë e duhura per minimizimin e rrezikut tëjetës,shendetit dhe pronës në rast të katastrofave natyrore te termeteve.
27. Bashkia Durrës nuk ka kryerveprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit e saj dhe për banorët që banojnë në territorin e sajë, siç është përcaktuar ne ligjin 45/2019 neni 30 pika d, në mënyrë që të shtohen kapacitetet dhe dijet në lidhje me ngjarje të emergjencave civile për të minimzuar dëmet nga fatkeqësitë natyrore në të ardhmen.

Rekomandime

27.1 AKMC në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe me Departamentin e Administratës Publike (DAP), të vijojë procesin e rekrutimit për plotësimin e strukturës organike në nivel qendror dhe vendor në mënyrë që të plotësohet stafi i punonjësve prej 106 punonjës që janë në strukturën organike.

Deri në prill 2022 e në vazhdimësi

28.1 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në vijimësi të zhvillojë e të kryejë trajnime për mbrojtjen civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, sipas programeve dhe moduleve të miratuara më parë nga Ministri për këtë qëllim.

Deri në qershor 2022 e në vazhdimësi

29.1 Bashkia Durrës në vijim të kryejë trajnimet për emergjencat civile për punonjësit dhe banorët e saj, në mënyrë që të sigurojë dijet e nevojshme në raste fatkeqësish natyrore dhe sidomos lidhur me tërmetet, për të minimizuar riskun e humbjes së jetës dhe pronave të banorëve që përfshin Bashkia Durrës.

Deri në qershor 2022

5. PËRMBLEDHJE

Objektivi kryesor i këtij auditimi ka qenë vlerësimi i politikave dhe efektivitetit të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin në tërësi të situatës së krijuar nga tërmeti i 2019 duke u fokusuar kryesisht në ÷përgjigjenë e subjekteve publike ndaj të dëmtuarëve si dhe në procesin e rindërtimit. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëse burimet publike janë manaxhuar me përgjegjësi dhe nëse janë arritur rezultatet e dëshiruara. Me anë të këtij objektivi do të mund të konkludojmë se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi lidhur me menaxhimin e tërmetit të nëntorit të 2019. Periudha e auditimit ka qenë nëntor 2019-prill 2021. Gjatë këtij auditimi janë zhvilluar vizita në terren kryesisht në Bashkinë Durrës. Subjektet kryesore ku është fokusuar ky auditim janë shtatë dhe konkretisht Ministria e Shtetit për Rindërtim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia e Tiranës dhe Durrësit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit, si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit, megjithatë gjatë fazës së terrenit, grupi i auditimit për të marrë rezultatet e dëshirueshme u përqendrua më së shumti në MSHR, AKMC dhe Bashkitë Tiranë dhe Durrës.

Masat e marra nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e tërmetit të nëntorit të 2019 nuk kanë qenë efektive. Krahas mungesës së hartimit dhe miratimit nga ana e AKMC të politikave me qëllim parandalimin, zbutjen dhe gatishmërinë të risqeve të katastrofave natyrore të cilat janë të përcaktuara në Ligjin nr 45/2019 ÷Për mbrojtjen civile, një ndër dokumentet kryesore i cili nuk është miratuar është Programi i Përgjithshëm i Rindërtimit i cili duhej të ishte miratuar nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit dhe të miratohej me VKM. Portali unik qeveritar i cili duhej të garantonte transparencën e plotë në funksion të përdorimit të fondeve të procesit të rindërtimit nuk është ndërtuar dhe nuk përmbush të gjitha detyrimet e përcaktuara në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ÷Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Fondet e alokuara në Bashkitë Tiranë dhe Durrës nuk janë bërë në përputhje të plotë me PDNA (*Post Disaster Needs Assessment* ó Vlerësimi i Nevojave Post Kastrofe) i cili është i vetmi dokument orientues që ka përllogaritur dëmet sipas sektorëve të veçantë si për shembull shëndetësi, arsim, infrastrukturë, banesa etj. Nga ana tjetër bashkëpunimi dhe koordinimi midis institucioneve nuk ka rezultuar plotësisht efektiv sa i përket shkëmbimeve të informacioneve, kontributeve në natyrë, trajnimeve për raste të fatkeqësive natyrore etj. Bashkitë Tiranë dhe Durrës nuk kanë dërguar të dhëna në AKMC lidhur me akt vlerësimit e bëra në subjekte të dëmtura nga tërmeti i 2019. Kanë kaluar gati 2 vjet nga tërmeti i nëntorit të 2019 dhe akoma evidentohen njerëz që kanë humbur banesat e tyre dhe që qëndrojnë në konteinerë të përkohshëm. Edhe pse me vonesë, miratimi i Programit të Përgjithshëm të Rindërtimit me qëllim planifikimin dhe përcaktimin e afateve kohore për përballimin e pasojave të tërmetit të 2019 do të ndihmonte të gjithë procesin e rindërtimit në tërësi.

Gjetjet e këtij auditimi kanë prekur elementë që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e kornizës ligjore dhe për këtë është përdorur si kriter kryesisht Ligji nr. 45/2019 ÷Për mbrojtjen civile. Grupi i auditimit ka gjeneruar gjetje që prekin fazën para dhe pas katastrofës, pra dokumenta politike që duhet të minimizojnë risqet dhe që fokusohen në parandalimin, zbutjen dhe gatishmërinë ndaj katastrofave natyrore si dhe dokumenta që duhej të ishin miratuar pasi ka ndodhur tërmeti i 2019. Krahas tyre është parë me përpikmëri dhe janë gjeneruar gjetje për zbatimin e dokumenteve politike apo kuadrit ligjor/rregullator pas rënies së tërmetit të 2019.

Një tjetër pyetje audituese mjaft e rëndësishme ishte edhe shpërndarja dhe alokimi i fondeve të procesit të rindërtimit. Për këtë pyetje janë gjeneruar disa gjetje që evidentojnë mos përputhje të alokimit të fondeve sipas vlerës së dëmeve të përllogaritur sipas sektorëve në PDNA. Koordinimi, bashkëpunimi, shkëmbimi i informacioneve e të dhënave si dhe trajnimi ishin të tjera çështje që janë trajtuar në këtë auditim dhe për të cilat janë gjeneruar disa gjetje të cilat theksojnë mangësi dhe mos arritje të rezultateve të dëshiruara të subjekteve nën auditim.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme janë dhënë rekomandime specifike për institucionet përkatëse shoqëruar me afatet kohore se kur duhen realizuar këto rekomandime.

6. ANEKSI

Vizita në terren

Grupi i auditimit në fazën e terrenit zhvilloi disa vizita në Njësinë Administrative Manëz të Bashkisë Durrës dhe veçanërisht në shkollën 9-vjecare ëZyber Sallakuö, dhe në gjimnazin Manëz. Në brendësi të territorit të shkollës 9-vjecare Manëz siç mund të shikohet dhe në foton nr. 1 më poshtë gjendeshin me dhjetëra konteinerë të cilët strehonin rreth 50 familje të cilat kishin humbur banesat e tyre si rezultat i tërmetit të 2019. Grupi i auditimit u fokusua gjatë fazës së terrenit në akt ekspertizën e thelluar të kryer nga Instituti i Ndërtimit për shkollën 9-vjecare ëZyber Sallakuö si dhe për gjimnazin Manëz. Për secilën godinë nga Instituti i Ndërtimit është përgatitur përkatësisht:

- Vlerësimi i aftësisë mbajtëse strukturore të ndërtesës ekzistuese në rrugën ëAli Beqjaö, Njësia Administrative Manëz, Bashkia Durrës me emërtimin shkolla 9-vjecare Zyber Sallaku;
- Vlerësimi i aftësisë mbajtëse strukturore të ndërtesës ekzistuese në rrugën ëRuga e Liqenitö, Njësia Administrative Manëz, Bashkia Durrës me emërtimin Shkolla e Mesme Manëz.

Bashkia Durrës me anë të VKB nr. 101 datë 31.08.2021 *ëMbi miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket Shkollës së Mesme Manëz (Kuçok), që mban nr. 04 të listës së transferimit, që me VKM nr. 538, datë 07.08.2012 bën pjesë në listën paraprake të pronave të ish Bashkisë Manëz (sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26.11.2019 dhe përbën rrezik për jetën dhe shëndetin, dhe rekomandimet të demoloohen, kjo sipas akt ekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista paraprake e pronave të godinës me emërtimin Shkolla e Mesme Manëz(Kuçok, me vendndodhje Njësia administrative Manëz, që me VKM nr. 538 datë 07.08.2012 bën pjesë në listën paraprake të pronave të ish Bashkisë Manëz (sot Bashkia Durrës), vendosi për prishjen e detyruar të kësaj godine.*

Për shkollën 9-vjecare ëZyber Sallakuö deri më sot sipas Bashkisë Durrës nuk ka asnjë vendim për prishje të detyruar.

Foto nr.1 Pamje nga konteinerët e vendosur në brendësi të Shkollës 9-vjecare “Zyber Sallaku”, Manëz



Burimi: Grupi i auditimit

Foto 2. Pamje nga Gjimnazi Manëz



Burimi: Grupi i auditimit

Aneksi 6.1 Observacione nga AKMC

Në mbështetje të neneve 26 dhe 29 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda 1 (një) muaji nga dita e marrjes së Projekt Raportit të Auditimit, AKMC me anë të shkresës me nr. 200/24 prot. datë 24.12.2021 dërgoi në KLSH komente mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës me temë "Efektiviteti i programeve për përbalimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore 2019".

Në këtë Aneks janë trajtuar vetëm observacionet e AKMC që janë në kundërshtim me gjetjet dhe rekomandimet e Projekt Raportit.

Lidhur me pyetjen e auditimit **"4.1.1 A ekzistojnë politika të duhura për parandalimin, zbutjen, dhe gatishmërinë ndaj katastrofave natyrore si rasti i tërmetit 2019"**, AKMC ka paraqitur disa observacione për gjetje dhe rekomandime të trajtuara më poshtë.

AKMC ka paraqitur disa sqarime për Gjetjen nr. 1 (fq 29) si më poshtë:

"Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë nuk është hartuar dhe miratuar duke mos përmbushur detyrimet e Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 10 pika 1, neni 23 pika 6 gërma "c" dhe neni 72 pika 1 gërma "a". Në nenin 72 pika 1 gërma "a" specifikohet se Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut duhet të ishte përgatitur deri në 2 vjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr 45/2019 "Për mbrojtjen civile". Mungesa e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë sjell automatikisht edhe mungesën e hartimit të Strategjive Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë nga ana e Njësive të Vetëqeverisjeve Vendore siç është edhe rasti i Bashkive Tiranë dhe Durrës".

Për këtë gjetje AKMC nuk ka kundërshtime të mirëfillta por vetëm disa sqarime ku ndër të tjera thekson se ka filluar puna për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Kjo në fakt është trajtuar edhe në konkluzionin nr. 1(fq 30) nga grupi i auditimit. Gjithashtu, AKMC është shprehur edhe për shtyrjen e afatit të zbatimit të rekomandimit i cili ishte lënë mars 2022. Grupi i auditimit mori në konsideratë ndryshimin e afatit për zbatimin e rekomandimit.

AKMC ka paraqitur disa sqarime për Gjetjen nr. 2 (fq 29) si më poshtë:

Vlerësimi i riskut në nivel qendror nuk është hartuar dhe nuk është miratuar me VKM në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 9 pika 3, neni 23 pika 6 gërma "c" dhe neni 72 pika 1 gërma "a". Në nenin 72 pika 1 gërma "a" specifikohet se Vlerësimi i riskut në nivel qendror duhet të ishte përgatitur deri në 2 vjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr 45/2019 "Për mbrojtjen civile".

Njësoj si për gjetjen më sipër, edhe për këtë gjetje AKMC nuk ka kundërshtime të mirëfillta por vetëm disa sqarime ku ndër të tjera thekson se ka filluar puna për përgatitjen e Vlerësimit të Riskut në nivel qendror. Kjo është trajtuar edhe në konkluzionin nr. 2 (fq 30) nga grupi i auditimit. AKMC është shprehur edhe për shtyrjen e afatit të zbatimit të rekomandimit i cili ishte lënë mars 2022. Grupi i auditimit mori në konsideratë ndryshimin e afatit për zbatimin e rekomandimit.

AKMC ka paraqitur disa sqarime për Gjetjen nr. 4 (fq 29) si më poshtë:

Plani Kombëtar i Emergjencave Civile i miratuar me VKM nr. 835 datë 03.12.2004 është bazuar në Ligjin nr. 8756, datë 26 mars 2001, "Për emergjencat civile", ligj që është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr 45/2019 "Për mbrojtjen civile". Krahas bazës ligjore, duke qenë se kanë kaluar rreth 17 vjet, ky plan nuk është i përshtatshëm dhe efektiv në kushtet e sotme duke qenë se gjatë

kësaj kohe institucionet dhe organizmat publike kanë pësuar ndryshime në organizimi si dhe në ndarje përgjegjësie sa i përket strukturave, duke e bërë të pamundur zbatimin e këtij plani.

Njësoj si për gjetjet më sipër, edhe për këtë gjetje AKMC nuk ka kundërshtime të mirëfillta por vetëm disa sqarime ku ndër të tjera thekson se ka filluar puna për përgatitjen e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile. Kjo është trajtuar edhe në konkluzionin nr. 3 (fq 30) nga grupi i auditimit. AKMC është shprehur edhe për shtyrjen e afatit të zbatimit të rekomandimit i cili ishte lënë më Mars 2022. Grupi i auditimit mori në konsideratë ndryshimin e afatit për zbatimin e rekomandimit.

Lidhur me pyetjen e auditimit **4.1.2 A kanë hartuar institucionet përgjegjëse politika të përshtatshme për përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019**, AKMC ka paraqitur disa observacione për gjetje dhe rekomandime të trajtuara më poshtë.

AKMC ka paraqitur disa sqarime për Gjetjen nr. 4 (fq 35) si më poshtë:

Edhe pse AKMC ka vënë në dispozicion të Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit disa specialistë, AKMC nuk ka dijeni për përbërjen e plotë të këtij Sekretariati dhe për rrjedhojë nuk ka mbajtur rregjistër protokollit më vete për veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit në kundërshtim kjo me VKM nr. 878 datë 24.12.2019 “Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit”, Kreu 4 pika 8.

Lidhur me këtë gjetje, AKMC është shprehur se pjesë e Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit janë 2 specialistë të AKMC. AKMC ashtu si edhe në kthim përgjigjet e pyetësorëve të dërguar elektronikisht në adresat e grupit të auditimit edhe në këto observacione ka paraqitur (me anë të shkresave nr. 7948/1 prot. datë 06.01.2020, nr. 531 prot. datë 27.01.2020, nr. 1533 prot. datë 11.12.2020, nr. 1533/1 prot. datë 21.01.2021, si dhe Urdhërave të Ministrit të Mbrojtjes nr 170 dhe 195 me nr prot 33/3 datë 11.02.2020) vetëm punonjësit që kanë qenë pjesë nga ana e saj në Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, **por asnjëherë listën e plotë të këtij Sekretariati**. Sa i përket regjistrit të protokollit të veprimtarisë së Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, AKMC nuk ka paraqitur asnjë dokument shtesë faktues që të provojë apo vërtetojë mbajtjen e regjistrit të protokollit. Kujtojmë se, me anë të përgjigjes me anë të emailit, më datë 02.08.2021 ora 13.58, AKMC ka pohuar grupit të auditimit se nuk ka dijeni për përbërjen e plotë të Sekretariatit Teknik të KSHR-së dhe as nuk ka mbajtur rregjistër protokollit për veprimtarinë e këtij Sekretariati.

Për sa më sipër, ky observacion nuk pranohet.

AKMC ka paraqitur disa sqarime për rekomandimin nr 4.1 (fq 57) si më poshtë:

AKMC të marrë masa që të sigurojë të dhëna për çdo kontribut në natyrë me qëllim përcjelljen e tyre në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit në përputhje me Aktin Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” neni 37, pika 8.

Rekomandimi ka theksuar që AKMC në vazhdimësi të marrë masa që të njoftohet për çdo kontribut në natyrë që mund të kenë siguruar Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Shkresa 1654/4 citon një tjetër auditim (përputhshmërie) të realizuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nuk bazohet në rekomandimin nr. 4.1 (fq 57) të lëna në këtë auditim performance.

AKMC ka paraqitur disa sqarime për gjetjen nr. 2⁴⁹ (fq 57) si më poshtë:

Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës nuk kanë dërguar në AKMC të dhëna që lidhen me akt vlerësimet paraprake dhe akt vlerësimet e thelluara jo në përputhje me Aktin Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” neni 15 pika 1.

⁴⁹Shënim: Këtu kemi të bëjmë me një lapsus nga ana e AKMC, sepse pavarësisht se kanë shkruar komente për rekomandimin nr. 2, në fakt ata i referohen gjetjes nr. 2 në fq. 57 të Projekt Raportit.

Në komentet e AKMC lidhur për këtë gjetje, tregohet me anë të dokumentave se ka filluar puna për ezaurimin dhe zbatimin e rekomandimit përkatës lidhur me këtë gjetje, çka dëshmon për pranimin dhe dakordësinë e AKMC lidhur me këtë gjetje.

AKMC ka paraqitur disa sqarime ne lidhje me gjetjen nr. 1 (fq 60) si më poshtë:

Aktualisht organika e AKMC numëron një staf prej 60 punonjësish. Organika e AKMC-së, nuk është plotësuar në përputhje me Urdhërin e Kryeministrit nr. 27., datë 3.2.2020, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKMC”, pika 7, sipas së cilës numri i përgjithshëm i punonjësve të AKMC-së duhet të jetë 106 vetë.

AKMC në sqarimin e saj, nuk ka kundërshtuar qëndrimin e grupit të auditimit në lidhje me mos plotësimin e organikës sipas Urdhërit të Kryeministrit nr. 27., datë 3.2.2020, òPër miratimin e strukturës dhe organikës së AKMCò, por thjesht ka sqaruar arsyet sipas saj, për mosplotësimin e strukturës organike me punonjës.

Për sa më sipër qëndrimi i audituesve të KLSH-së nuk ndryshon në lidhje me gjetjen, rrjedhimisht që gjetja qëndron siç është trajtuar në projekt raportin e auditimit.

AKMC ka paraqitur disa sqarime ne lidhje me gjetjen nr. 2 (fq 60) si më poshtë:

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile nuk ka kryer asnjë trajnim me Strukturat e Emergjencave/Mbrojtjes Civile, në Bashkinë Durrës siç përcaktohet në nenin 63 pika 1 të ligjit 45/2019 ku citohet :“ Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen trajnime për mbrojtjen civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, sipas programit dhe moduleve të miratuara më parë nga ministri për këtë qëllim” si dhe nenit 23 pika 6 gërma ë, ku citohet: “AKMC nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Trajnimeve për Mbrojtjen Civile, kryen trajnimet e strukturave shtetërore, të subjekteve private e vullnetare”.

AKMC në sqarimin e saj, nuk ka kundërshtuar qëndrimin e KLSH-së në lidhje me mos realizimin e trajnimeve me Strukturat e Emergjencave/Mbrojtjes Civile, në rastin konkret në Bashkinë Durrës, siç përcaktohet në nenin 63 pika 1 të ligjit 45/2019,por thjesht ka dëshmuar që ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjetja është specifikuar në lidhje me mostrajnimin e strukturave të Emergjencave/Mbrojtjes Civile për Bashkinë Durrës.

Për sa më sipër qëndrimi i audituesve të KLSH-së nuk ndryshon në lidhje me gjetjen,rrjedhimisht që gjetja qëndron siç është trajtuar në projekt raportin e auditimit.

AKMC ka paraqitur disa sqarime ne lidhje me rekomandimin nr. 2.1 (fq 61) si më poshtë:

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në vijimësi të zhvillojë e të kryejë trajnime për mbrojtjen civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, sipas programeve dhe moduleve të miratuara më parë nga Ministri për këtë qëllim.

Lidhur me këtë rekomandim AKMC nuk ka shprehur kundërshtim, por është zotuar se do ta realizojë këtë rekomandim.

Aneksi 6.2 Observacione nga Bashkia e Tiranës

Në mbështetje të neneve 26 dhe 29 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda 1 (një) muaji nga dita e marrjes së Projekt Raportit të Auditimit, Bashkia e Tiranës me anë të shkresës me nr. 200/25prot. datë 12.01.2022 dërgoi në KLSH komente mbi Projekt Raportin e Auditimit të Performancës me temë "Efektiviteti i programeve për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore 2019". Në përgjithësi Bashkia e Tiranës nuk ka shprehur kundërshtime lidhur me Projekt Raportin e Auditimit, por vetëm ka sqaruar dhe ka bërë me dije që do të zbatojë rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit. Njëkëtë Aneks janë trajtuar vetëm observacionet e Bashkisë së Tiranës që janë në kundërshtim me gjetjet/rekomandimet e Projekt Raportit.

Lidhur me pyetjen e auditimit **4.2 A është siguruar një shpërndarje e drejtë e fondeve të rindërtimit me qëllim përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit të 2019**, Bashkia e Tiranës ka paraqitur observacione lidhur me rekomandimin e 4.1 si më poshtë.

4.1. Bashkia Tiranë të marrë masa për identifikimin dhe përfshirjen e zërave "plane vendore", "hartim projekti", "shpronësim", "ndërtimi i objekteve arsimore", në përputhje me përcaktimin në Aktin Normativ Nr.9 datë 16.12.2019" Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Bashkia e Tiranës në sqarimin e saj ka argumentuar se: "Hartimi i planeve vendore referuar VKM-së nr. 9 datë 10.01.2020, hartimi i projekteve referuar VKM-së nr. 10 datë 10.01.2020, Rindërtimi i objekteve arsimore referuar VKM-së nr. 212 datë 11.03.2020; janë 3 VKM-të e para sipas të cilave na janë akorduar fondet e rindërtimit. Në klasifikimin e tyre kemi vijuar duke u bazur në emërtimin e VKM-ve të miratuara si dhe programeve tona buxhetore (COFOG), sepse hartim planesh apo projektesh nuk gjejnë specifikim në Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019. E njëjtja gjë ka ndodhur edhe me shpronësimet, të cilat edhe këto nuk kanë një kategorizim të qartë në Aktin Normativ dhe si rrjedhojë kemi vijuar me klasifikimin sipas COFOGö.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në Aktin Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, nën 19 pika 3 dhe 6 respektivisht flitet për hartimin e planeve të detyruara vendore dhe shpronësimet. Në këtë nen përshkruhet specifikisht "Programi i zhvillimit të objekteve të reja" ku bëjnë pjesë edhe planet e detyruara vendore dhe shpronësimet. Edhe projektet përmenden në nenin 20, nenin 23 dhe 30, nën të cilat përshkruajnë programet e procesit të rindërtimit. Rekomandimi jonë ka për qëllim që të gjitha zërat e cituara në rekomandim të përkojnë dhe të jenë pjesë e një prej pesë programeve të procesit të rindërtimit, referuar nenit 18 të Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Për të gjitha këto, rekomandimi 4.1 nuk ndryshohet.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT